

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7587 E premte 13 Korrik 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion i Ditës

Në një video të publikuar së fundmi ku shefat e vendeve anëtare të NATO-s bëjnë një bisedë të lirshme në një holl të madh, shikohet Rama që i afrohet...

Vijon në faqen 20

Nga DRITAN HILA

Rama, kroatët dhe provincializmi ynë kombëtar



Opinion i Ditës

Raporti tronditës i Drejtorisë së Antidrogës Italiane demaskon përfundimisht qeverinë shqiptare dhe ndërkombëtarët që heshtën. Ja çfarë paraqet shumë ...

Vijon në faqen 21

Nga MONIKA KRYEMADHI

Për 3 muaj e pastrojmë Shqipërinë nga droga e llumi



Biseda në prani të sekretarit Mike Pompeo

Rama takon Trump, Xhaçka: Presidenti i SHBA ia lavdëroi posaçërisht fjalimin

Samiti i NATO, 'sekretet' e darkës. Bushati: Mposhtja e terrorizmit, sfidë për Ballkanin

DARINA TANUSHI

Kryeministri Edi Rama bisedoi djë në Bruksel me Presidentin amerikan, Donald Trump. Takimi u zhvillua në kuadër të Samitit të NATO-s, ndërsa kryeministri Edi Rama shpërndaui "Foton e Ditës", përmes ...

Në faqen 3

AGJENCIA E PRONAVE PUBLIKON LISTEN E PERFITUESVE NGA FONDI I ALUIZNI-I

900 PRONARET QE MARRIN KOMPENSIM, EMRAT E RINJ

Familjet që kanë ndërtuar pa leje dhe marrin tapitë në Tiranë dhe në rrethe. Formulari dhe dokumentet, ja kërkesat që duhet të plotësojnë pronarët në ATP



(Në foto) Ndërtime pa leje

Në faqen 10-11

KRYETARI I PD

Basha përgjigjet për "Muzin": Lobimi në SHBA për strategjinë kundër krimit

Në faqen 2-3

VERIFIKIMI

Dyshimi për 10 mijë eurot e dhuruara, vetingu rrezikon gjyqtarin Dizdari

Në faqen 7

PERPLASJA "POLITIKE"

FNSH, aksion në Velipojë, nën sekuestro 500 shezlonge pa leje

Në faqen 6

ARSIMI I LARTE

"Luarasi", pakt bashkëpunimi me qendrën "Gratë në Shërbim Publik"

Në faqen 9

HISTORIA/ ROLI I SIGURIMIT



Dëshmia në hetesë, një franceze në Tiranë, dashuria e pamundur e Maks Velos

Në faqen 18



Rrëfhet stilistja e njohur: Puna, pasion dhe profesion si binom perfekt

Rezarta Skifteri: Moda, ja tendencat e verës

Besi dhe Xhensila bëhen prindër. Françeska Jaçe çudit: Jam e virgjër

Nga EGLA XHEMALI

Ajo është një nga stilistet më të njohura dhe më të dashura në Shqipëri. Bëhet fjalë për Rezarta Skifterin. Bukuroshja vjen në një rrëfim ekskluziv për suplementin "Summer Pages"



në një dimension tjetër. Rezarta na tregon për aktivitetet që e mbajnë në formë, për dashurinë e madhe që ka për punën e saj, për projektet që ka jashtë kufijve e së fundmi i sugjeron vajzat në lidhje me tendencat e fundit të kësaj vere ...

Suplement

"DREJTËSIA" INTERVISTA

PD firmos kontratën e re të lobimit në Uashington, kërkon ndihmën e një kompanie amerikane

Basha: Lobimi në SHBA për strategjinë kundër krimit

"3.4 mln eurot i perkasin një klani të fuqishëm kriminal"

Kreu i PD, Lulzim Basha, mori pjesë në një konferencë të organizuar nga Instituti "Hudson", në Uashington lidhur me marrëdhëniet transatlantike. Në një intervistë për "Zërin e Amerikës", Basha ndalet në problemet e fundit me të cilat ndeshet Shqipëria, si ngërçi lidhur me shkollën e magistraturës, ligji për Teatrin Kombëtar, krimi i organizuar dhe korrupsioni. Basha po ashtu iu përgjigj edhe pyetjeve lidhur me kontratat që PD-ja ka nënshkruar me firma lobuese amerikane.

Z.Basha, cili është synimi i qëndrimit tuaj në Uashington këto ditë?

Jam këtu me një ftesë të Institutit "Hudson", i cili së bashku me Institutin Republikan Ndërkombëtar IRI dhe me "think tank"-un e Partisë Popullore Europiane, Institutin Martens kanë organizuar në Uashington konferencën e 9 transatlantike, që ka mbledhur bashkë politikanë, eurodeputetë, deputetë të vendeve anëtare të Bashkimit Europian, kongresmenë, senatorë dhe njerëz të "think tank"-eve amerikane për të diskutuar gjendjen aktuale të marrëdhënieve transatlantike dhe për të diskutuar për të ardhmen e këtyre marrëdhënieve, po kështu edhe të NATO-s.

Muajin e kaluar ju keni nënshkruar një marrëveshje të re lobimi me një firmë amerikane për një shumë prej 40 mijë dollarësh, për një periudhë katërmujore, pra 10 mijë dollarë në muaj. Për çfarë keni nevojë për të lobuar në Uashington, kur marrëdhëniet e Shqipërisë me SHBA-të janë të shkëlqyera dhe të dyja vendet janë partnere?

Nuk ka diskutim, por problemet kryesore me të cilat përballlet Shqipëria kanë nevojë për një ekspozim të plotë dhe të gjithanshëm, në veçanti sa i përket institucioneve, të cilat merren me këto probleme. Pikërisht këtu kemi kërkuar ndihmën e një kompanie, e cila është e specializuar në veçanti sa i përket krimit të organizuar, narkotikëve dhe terrorizmit. Pikërisht ky është edhe qëllimi i kësaj kontrate: hartimi i një strategjie kundër krimit të organizuar dhe kundër trafikut të drogës, e cila do të bëjë pjesë në planin, programin dhe vizionin e partisë demokratike, së bashku me komponentin ekonomik, të cilin e kemi mbaruar tashmë me partnerët tanë gjermanë, me anë të të cilave do t'u ofrojmë shqiptarëve vizionin tonë për të çmontuar kapjen e shtetit nga interesat kriminale, kapjen e shtetit nga interesat e rrytjeve kriminale të trafikut të drogës dhe pastrimit të



Kreu i PD-së, Lulzim Basha

parave dhe për t'u dhënë shqiptarëve një vend të sigurt, me një ekonomi të sigurt e të fortë, ku nuk dikton paraja e krimit dhe drogës, po ku dikton puna e ndershme dhe mundësia për të gjithë.

Cila është e vërteta e pagesës prej 500 mijë dollarësh për lobimin e PD-së?

E vërteta është se PD-ja ka bërë atë kontratë që ka bërë dhe ka bërë ato pagesa që ka bërë. Ndryshe nga Partia Socialiste, e cila...

PD-ja ka bërë një pagesë, siç thotë firma Muzin në deklaratën e saj, prej 500 mijë dollarësh?

Partia Demokratike ka bërë atë kontratë që ka bërë, që e ka publike dhe ka bërë ato pagesa që ka bërë. Kjo është e vërteta...

Pra, firma "Muzin" nuk tregon të vërtetën?

E për çdo gjë tjetër ne i kemi kërkuar prokurorisë në Shqipëri dhe FBI-së në hetojnë. Partia Demokratike nuk ka shkelur asnjë ligj, nuk ka asnjë para të pistë në këtë mes, ndryshe nga afëra e famshme e thyerjes së ligjeve amerikane me foton me Obamën dhe me burimet e panjohura të parave, që paguan për këtë të tjerë. Partia Demokratike është tërësisht transparente, krejtësisht e hapur, kështu që kjo nuk është çështje.

Firma Muzin, sipas kësaj që po thoni ju, duket se ka përdorur emrin e partisë suaj për çfarëdo problemi që ka pasur vetë. Pra, ju ka prishur juve imazhin. Pse nuk e denonconi ju këtë firmë për të pastruar emrin tuaj, sepse del emri i partisë suaj gjithmonë?

Aspak. PD i ka deklaruar gjithmonë në mënyrë transparente marrëdhëniet dhe financat e saj, ndryshe nga Partia Socialiste në të kaluarën dhe në të sotmen. Por kjo është një çështje, e cila besoj se do të diskutohet dhe do të bëhet transparente më vonë. Këtu nuk ka asnjë çështje. Është një non-issue, siç i thonë në Amerikë. Partia Demokratike është e angazhuar në denoncimin e lidhjeve të krimit të organizuar me partinë në pushtet, duke përfshirë edhe pastrimin e parave dhe gjithçka për të cilën Partia Demokratike akuzohet është një manovër e dobët diversioni për të tërhequr vëmendjen dhe për të kaluar Partinë Demokratike në pozita mbrojtëse, oka nuk ka për të ndodhur.

Nga reforma në drejtësi, shumë gjykatës po humbasin vendet e punës, por sistemi i drejtësisë do të ketë nevojë për zëvendësimin e tyre. Janë një grup studentësh, që kanë kryer Shkollën e Magistraturës dhe një grup tjetër që pritet të shkojnë atje. Cfarë propozoni për kapërcimin e bllokimit me studentët e magistraturës?

E rëndësishme është të kuptojmë se çfarë po ndodh. Vetingu i gjyqtarëve dhe prokurorëve po ecën me këto ritme të ngadalta, pasi PS ka hedhur poshtë kërkesën edhe të organeve të vetingut edhe të opozitës për t'u pajisur me një buxhet të mjaftueshëm dhe me burime njerëzore, në mënyrë që vetingu të ecë më shpejt. PS votoi për të prerë me 40 për qind buxhetin e propo-

TAKIMI

I ndodhur prej disa ditësh në SHBA, Lulzim Basha mori pjesë në evenimentin e Institutit "Hudson", ku u diskutuan sfidat me të cilat përballlet Aleanca e Atlantikut të Veriut. Për kreun e demokratëve, NATO është një garancë më shumë për paqen, stabilitetin dhe demokracinë në Ballkan.



Samiti i NATO-s

zuar nga organet e vetingut. Tani organet e vetingut nuk janë në gjendje të përparojnë me ritmet e duhura, duke vënë në pikëpyetje kalendarin e reformës në drejtësi, duk shtrë kërkimin e KLGJ-së dhe KLP-së, shtyrje që është antikushetuese, sepse me Kushtetutë këto dy organe duhet të ishin krijuar prej kohësh. Në vend të korigjohë atë që ka bërë vetë gabim, pra miratimin e njëanshëm të ligjit të vetingut dhe injorimin e propozimeve të opozitës, në vend që të rikthehet te Kushtetuta, në vend që të rikthehet te propozimet tona, se kanë qenë edhe propozimet tona për të mbështetur me financime dhe burime njerëzore komisionet e vetingut, tani ai po propozon të krijojë institucione jashtë kuadrit të reformës në drejtësi, të cilat të kenë mundësinë që edhe pa veting të emrojnë gjyqtarë dhe prokurorë. E ka bërë këtë me prokurorin e përgjithshëm, e cila u emërua në kundërshtim me Kushtetutën, tani do t'i japë kësaj prokurorëje të përgjithshme dhe KLD-së kompetenca për të futur pa veting dhe jashtë procedurave kushtetuese kandidatë në sistemin e drejtësisë.

Si dilet nga kjo gjendje?

Nga kjo gjendje dilet vetëm duke u rikthyer te konsensusi kushtetues dhe duke u rikthyer te Kushtetuta, e cila u miratua me 140 vota. Pasi ajo u miratua me 140 vota, PS miratoi 6 ligje, duke përjashtuar opozitën, pasi kishte dhënë fjalën se këto 6 ligje do të bëheshin me konsensus, pikërisht që të na sillte në këtë pikë; që të vonohej krijimi i organeve të reja të drejtësisë, që të emërohej prokurorja e përkohshme me votat vetëm të maxhorancës dhe jashtë parashikimeve kushtetuese dhe që të bllokoheshin heqja e bllokimit kundër korrupsionit dhe krimit të or-

ganizuar. Rruga është të zhbehen ato komponentë të futuri në mënyrë të njëanshme nga maxhoranca, pikërisht për të vonuar krijimin e organeve të reja të drejtësisë, për të vonuar krijimin e KLGJ-së dhe KLP-së, duke vonuar kështu krijimin e SPAK-ut dhe të BKH-së dhe duke mos ia dhënë pushtetin reformimit të drejtësisë vet organeve të drejtësisë, por Fatmir Xhafaj dhe Arta Marku, të emëruar vetëm me votat e Edi Ramës dhe rezultatit po e shohim: Saimir Tahiri bledh i lirë, bandave të mëdha të trafikut të drogës nuk u hyn asnjë gjemb në këmbë, drogë dhe para të drogës dalin e hyjnë nëpër portet e Shqipërisë dhe Shqipërisë i mbeten të mbyllura dyert e negociatave me Bashkimin Europian për shkak të krimit dhe të korrupsionit.

Një tjetër çështje e nxehtë javë e fundit në Shqipëri është edhe çështja e Teatrit Kombëtar. Si mund ta bllokoni ju ligjin, kur PS i ka kartonët në parlament?

Ne nuk kemi mundësi të bllokimë ligjin dhe këtë ua kemi bërë të qartë artistëve, qytetarëve dhe gjithë faktorëve shoqërorë të shtetësuar nga gjithë kjo afërë e tmerrshme korruptive. Çfarë po ndodh? Edi Rama ka një plan thuajse 20-vjeçar për të ndërtuar kulla në këtë zonë, që është në zemër të qytetit, është praktikisht prapa monumentit të Skënderbeut, është në mesin e sheshit të ministrive. Ai ka më shumë se një vit që harton një plan, i cili mbahet i fshehtë për të ndërtuar 6 kulla në zonën e Teatrit e për këtë qëllim duhet grabitur teatri, duhen grabitur afro 8 mijë metër katrorë tokë publike, nga të cilat afro 5 mijë i takojnë teatrit. Kjo grabitje bëhet përmes një kompanie, e cila është pronare apo ka blerë 280 metër katrorë. Me 280

metër katrorë që ka në pronësi kjo kompani, tani bëhet një ligj special në emër të kësaj kompanie për t'i dhënë edhe 8 mijë metra të tjerë nga toka publike. Pra, është një aferë e pastër korruptive, për të bërë qindra milionë euro me ndërtimin e këtyre 6 kullave. Është një projekt betonizimi dhe po ashtu, është një projekt i pastrimit të parave të pista.

Cila është strategjia juaj për t'u kundërvënë këtij projekti?

Strategjia jonë është ajo që kemi ndjekur deri sot, kundërshtimi ligjor në komisionare dhe seancë parlamentare, thirrja që i kemi bërë presidentit për të mos e dekretuar ligjin, vazhdimi i kundërshtimit tonë në kuptimin e institucioneve ligjore, është thirrja që i kemi bërë faktorit ndërkombëtar, në veçanti ambasadorëve, që të reagojnë ndaj këtij akti të paprecedent korruptiv; një ligj special për të grabitur tokë publike dhe për të pastruar paratë e drogës e të krimit. Natyrisht, është mbështetja me të gjitha format dhe mënyrat e protestës së artistëve dhe të qytetarëve, pasi ndodhemi para një akti të rëndë kriminal dhe para një veprë të rëndë antikushetuese, para një atentati ndaj Kushtetutës. Pse? Në mungesë të Gjykatës Kushtetuese, ky ligj nuk është gjë tjetër veçse një ligj i vjedhjes, një akt që legjitimim vjedhjen. Pra, vjedhja dhe korrupsioni nuk janë probleme të reja në Shqipëri, por kjo është hera e parë kur mazhoranca në parlament voton për të ligjëruar vjedhjen. Kjo përbën një precedent të rrezikshëm nga kjo pikëpamje, ndaj duhet refuzuar dhe jam i bindur se do të arrihet me bashkimin e forcave të gjithë qytetarëve, pavarësisht bindjeve politike.

Z.Basha, pak javë më parë bëri përshtypje deklarata juaj në parlament që



Ministrja e Mbrojtjes: Presidenti i SHBA përshëndeti posaçërisht kryeministrin

Samiti i NATO-s, Rama shtrëngon duart me Trump, biseda në prani të Pompeo

Bushati: Mposhtja e terrorizmit, sfidë për rajonin

Darina Tanushi

Kryeministri Edi Rama bisedoi dje në Bruksel me Presidentin amerikan, Donald Trump. Takimi u zhvillua në kuadër të Samitit të NATO-s, ndërsa kryeministri Edi Rama shpërndau "Foton e Ditës", përmes rrjetit social "Facebook". Po ashtu, i pranishëm në këtë takim ishte edhe Sekretari Amerikan i Shtetit, Mike Pompeo. "Në seancën e sotme plenare të Samitit të NATO-s, Presidenti Trump përshëndeti posaçërisht kryeministrin Edi Rama për fjalën e tij në darkën e mbrëmshme të liderëve të Aleancës", shkroi ministria



Kryeministri Edi Rama, dje në Bruksel me Presidentin amerikan, Donald Trump

PRESIDENTI META

Presidenti Ilir Meta përshëndeti ftesën e NATO-s për anëtarësimin e Maqedonisë Veriore në këtë union. "Samiti i NATO në Bruksel përforcoi lidhjen jetike transatlantike përmes vendimeve edhe më angazhuese për të gjithë. Përshëndes ftesën për anëtarësim drejtuar Republikës së ardhshme të Maqedonisë Veriore, katalizator për më shumë siguri dhe stabilitet në Ballkanin Perëndimor", tha Meta.

i parapriu një aksioni të policisë për zbulimin e 3.4 milionë eurove në makinë që vinin nga jashtë. Cili ishte burimi juaj i informacionit?

PD-ja ka një bashkëpunim të ngushtë me partinë ndërkombëtare, për të cilët lufta ndaj krimit të organizuar, trafiqeve të drogës dhe korrupsionit është një prioritet absolut

Ju akuzuan se me këto automjete "Toyota" ishte i lidhur një deputet i Partisë Socialiste. Ai u kthye me akuzë kundër jush për një fotografi, që ju kenë bërë me vëllain e njërit prej të arrestuarve në zyrën tuaj. Në ç'rrethana është bërë ajo foto?

Nuk kam asnjë kujtesë për rrethanat e fotos, sepse unë kam fotografi me mijëra qytetarë. E rëndësishme është të kuptojmë dy gjëra: e para, të kuptojmë hipokrizinë e pretendimit, sepse nëse ky person, që nuk e njoh, është i dyshuar, kanë kaluar më shumë se tre javë dhe ky person mund të ishte arrestuar, mund të ishte marrë në pyetje. Por kjo nuk ka ndodhur dhe ka një hipokrizi këtu dhe një përdorim të qartë politik të një fotoje, për të cilën nuk kam asnjë informacion përtej asaj që kam bërë publike. E dyta, është standardi moral. Unë akuzohem se paskam dalë në foto me dikë, i cili dyshohet se është vëllai i disave, që dyshohen se janë prapa këtyre parave. Ndërkohë që informacioni im është fare i qartë: këto para janë para të drogës të një klani të fuqishëm kriminal me qendër në Elbasan dhe numri dy i Partisë Socialiste, jo një deputet çfarëdo, është garant i marrëveshjes për kalimin e këtyre parave përmes këtij instrumenti, makinave të sjella në Tiranë. Po kështu, për të qëndruar të standardi moral, kryeministri, vetë ky person dhe shumë të tjerë janë ditë për ditë në krah të vëllait të një kriminali të dënuar droge, siç është ministri aktual i Brendshëm, Fatmir Xhafaj.

Balla: Financimi rus zyrtarisht nën hetim amerikan, Basha të japë sqarime

Kreu i grupit parlamentar të Partisë Demokratike, Taulant Balla kërkoi dje nga kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha që të mos fshihet, por të sqarojë publikun për financimin rus, tashmë zyrtarisht nën hetim amerikan. "Prej disa muajsh tashmë janë bërë publike nga mediat më prestigjioze amerikane transferatet e paligjshme, që pa asnjë deklaram. Partia Demokratike ka bërë për llogari të lobistëve të saj përpara zgjedhjeve të 25 qershorit 2017. Deklaratat e regjistruara në Departamentin Amerikan të Drejtësisë dëshmuuan se fotoja me Presidentin Trump dhe mbështetja e një numri kongresmenësh, në prag të zgjedhjeve, i ka kushtuar Partisë Demokratike me qindra mijëra dollarë, prejardhja e të cilave nuk është bërë asnjëherë e ditur nga Lulzim Basha", shkroi dje Balla në një postim në "Facebook". "Megjithatë - thekson Balla - një investigim i një prej mediave më autoritare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës nxori në dritë të dhëna të reja skandaloze, të cilat lidhin direkt Partinë Demokratike dhe Lulzim Bashën me financime të dyshimta ruse. Sipas këtij investigimi, të bazuar mbi dokumentet zyrtarë të Departamentit Amerikan të Drejtësisë, Nick Muzim, lobuesi kryesor i demokracitëve në SHBA, është paguar jo vetëm nga Partia Demokratike, por edhe nga një kompani fantazme e regjistruar në Skoci, e quajtur "Bini-atta Trade". Balla i kërkoi Bashës të mos fshihet.

Kreu i Kuvendit në Samitin e Varshavës: Reforma në drejtësi, unike

Ruçi, thirrje për bashkëpunim mes vendeve: Ylli ynë polar të jetë BE

Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë, Gramoz Ruçi bëri thirrje për një zhvillim të qëndrueshëm dhe kohezion social gjatë fjalës që mbajti në Samitin e Kryetarëve të Parlamenteve të Evropës Qendrore e Lindore në Varshavë. Në fjalën e tij të mbajtur në samit, kryetari Ruçi vuri në dukje se, "Evropa Qendrore dhe Lindore përbën një ndërzonat ekonomike e politike më të rëndësishme të globit dhe një thesar kulturor të njerëzimit, të cilin ne banorët e tij duhet ta ruajmë e pasurojmë. Gjatë tri dekadave të fundit, krahas valëve të demokratizimit, vendet tona janë përfshirë njëkohësisht në proceset e modernizimit, perëndimimit dhe evropianizimit. Pavarësisht diferencave midis tyre, ato konvergojnë në



një drejtim kryesor: vlerat evropiane. Evropianizimi i shoqërive tona është tipar i kohës, prandaj bashkëpunimet tona dypalëshe dhe rajonale duhet të kenë si yll polar Bashkimin Evropian, si një bashkim vlerash, aspiratash, vizioneesh dhe qytetarësh evropianë", thek-

soi Ruçi. Ruçi falënderoi parlamentet e Polonisë, Austrisë, Bullgarisë, Kroacisë, Republikës Çeke, Estonisë, Greqisë, Hungarisë, Letonisë, Lituanisë, Rumanisë dhe Sllovakisë, për mbështetjen që u dhanë qeverive të tyre për qëndrim pro hapjes së negociatave me Shqipërinë. "Ba-shkëpunimi ndërparlamentar duhet të bëhet promotori i përpjekjeve të vendeve tona për një mirëqenie e jetë cilësore, një shoqëri demokratike e paqësore dhe të ardhme të sigurt", tha më tej Ruçi. Ai foli edhe për reformën në drejtësi, duke e cilësuar atë një reformë unike në rajon. "Rezultatet e kësaj reforme janë të prekshme dhe mbresëlënëse", tha Ruçi, i cili në këtë aktivitet shoqërohej nga kryetari i grupit të PS-së, Taulant Balla.

një objektiv kyç për të gjitha vendet tona dhe një sfidë për stabilitetin e rajonit", - vuri në pah ministri Bushati. Sipas Bushatit, në samit u rikonfirmua rëndësia strategjike e rajonit të Ballkanit Perëndimor për sigurinë e Aleancës, si dhe roli i Shqipërisë, në vendimmarrjen dhe në politikëbërjen e Aleancës. "Shqipëria ka një kontribut kryesisht me misionet

në jug të Aleancës. Do të vijojë t'u përmbahet këtyre angazhimeve, qoftë në aspektin financiar ashtu edhe sa u përket investimeve të ndryshme", tha Bushati. Samiti i NATO-s është shoqëruar me debate me Presidentit të SHBA-ve dhe liderëve të BE për përmbytjen e detyrimeve të vendeve anëtare për të rritur shpenzimet për mbrojtjen në nive-

lin e 2% të Prodhimit të Brendshëm Bruto. Një fakt të tillë e ka pohuar edhe ministri i Jashtëm shqiptar Ditmir Bushati, i cili ishte edhe pjesë e delegacionit të Shqipërisë në këtë samit. "Kur flasim për shpenzimet për politikën e mbrojtjes nuk kemi parasysh thjesht aspektin financiar, por edhe kontributet që japin vendet e ndryshme", sqaroi Bushati

KORRUPSIONI RAPORTI

Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit i KiE: Shqipëria përmbushi 4 nga 10 rekomandime

Darina Tanushi

Organizmi i Këshillit të Europës për luftën kundër korrupsionit njih përparimin në Shqipëri, por kërkon veprim të mëtejshëm. Në një raport të botuar dje, Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit i Këshillit të Europës (GRECO) njih përparimin e bërë nga Shqipëria në zbatimin e rekomandimeve të saj për të parandaluar korrupsionin në lidhje me parlamentarët, gjyqtarët dhe prokurorët, por gjithashtu, kërkon një sërë përmirësimesh dhe përfundimin e reformave të mbetura pezull. Në raportin e saj, GRECO arrin në përfundimin se, "Shqipëria deri më tani ka përmbushur plotësisht katër nga 10 rekomandimet që ka nxjerrë në raportin e saj të vlerësimit në vitin 2014. Të gjashtë rekomandimet e tjera janë zbatuar vetëm pjesërisht". GRECO e mirëpret si një hap të rëndësishëm miratimin e Kodit të Sjelljes për deputetët në prill 2018, i cili përfshin çështje të tilla si konflikti i interesave; aktivitetet shtesë; dhuratat dhe kufizimet pas punësimit. "Konfliktet e interesit duhet të deklarohen nga deputetët kur ato shfaqen dhe, gjithashtu, një procedurë është përcaktuar për të siguruar që kontaktet e deputetëve me palët e treta gjatë procesit legjislativ të raportohen, regjistrohen dhe bëhen publike". Megjithatë, GRECO shpreh keqardhjen për mungesën e qartësisë në lidhje me zbatimin e këtyre rregullave dhe sanksioneve në rast shkelje, të cilat nuk përmenden shprehimisht në tekstin e Kodit të Sjelljes dhe nënvojën nevojën për një mekanizëm zbatimi, duke përfshirë sanksionet, për ta bërë kodin efektiv. Asambleja Kombëtare po planifikon të hartojë udhëzime për të hedhur dritë mbi rregullat e përfshira në Kodin e Etikës, por ato duhet të miratohen. Ndërgjegjësimi dhe trajnimi i deputetëve për këto rregulla është ende në fazën e përgatitjes. Raporti, gjithashtu, njih si një hap pozitiv faktin që periodiciteti i kontrolleve të deklarimit të aseteve nga ana e deputetëve është shkurtuar dhe se ato publikohen në një faqe zyrtare. Në lidhje me gjyqtarët, një reformë e madhe gjyqësore është në vazhdim e sipër që nga viti 2014 dhe po ashtu është një proces verifikimi për gjyqtarët me qëllim luftën kundër korrupsionit në gjyqësor. GRECO përhëndet faktin që, si pjesë e paketës së reformës, roli i Presidentit të Republikës është kufizuar

Raporti i GRECO: Më shumë kritere për standardet etike të prokurorëve

"Deputetët të deklarojnë konfliktin e interesit"



"Përpjekje të mëtejshme për ndjekjet penale në luftën antikorrupsion"

Nënkomiteti BE-Shqipëri për Drejtësinë: Të nisë puna me fokus te shteti ligjor

Nënkomiteti i Stabilizimit dhe Asociimit BE-Shqipëri për Drejtësinë, Lirinë dhe Sigurinë mbajti takimin e tij të dhjetë të 11-12 korrik në Tiranë. Takimi u bashkëkryesua, për Bashkimin Evropian nga Znj. Michela Matuella, shefe e Njësisë në Drejtorinë e Përgjithshme për Politikën Evropiane të Fqinjësisë dhe Negociatave dhe Zgjerimit të Komisionit Evropian, ndërsa për Shqipërinë nga Z. Gent Cakaj, zëvendësministër për Evropën dhe Punët e Jashtme. Në takim u diskutua për funksionimin e gjyqësorit, politikën kundër korrupsionit dhe të drejtat themelore, azilin dhe migracionin, menaxhimin e kufijve dhe politikën e vizave, luftën kundër korrupsionit dhe korrupsionit të organizuar dhe terrorizmit, luftën kundër pastrimit të



parave, si dhe policinë dhe bashkëpunimin gjyqësor. Komisioni përhëndeti progresin e qëndrueshëm të arritur nga Shqipëria gjatë vitit të kaluar dhe kujtoi se ndjekja e zbatimit të reformës në drejtësi është e dobishme për forcimin e shtetit ligjor në vend. Komisioni dhe autoritetet shqiptare ranë dakord për rëndësinë që ka për vendin vazhdimi dhe shtimi i përpjekjeve në luftën kundër korrupsionit dhe korrupsionit të organizuar, në veçanti lidhur me luftën kundër pastrimit

në emërimin formal të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë me propozimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor; i përbërë nga një shumicë e gjyqtarëve të zgjedhur nga kolegët e tyre. Zhvillime të tjera pozitive me përfundimin e reformës konsistojnë në faktin se funksionimi i administratës gjyqësore

nuk do të jetë më nën përgjegjësinë e Ministrisë së Drejtësisë, por të Këshillit të Lartë të Gjyqësorit; dhe se Këshilli i Lartë i Gjyqësorit do të jetë përgjegjës për vendosjen e standardeve etike dhe monitorimin e tyre. GRECO konsideron një hap tjetër pozitiv krijimin e një Inspektori të

ROLI I PRESIDENTIT
"GRECO përhëndet faktin që, si pjesë e paketës së reformës, roli i Presidentit të Republikës është kufizuar në emërimin formal të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë me propozimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, i përbërë nga një shumicë e gjyqtarëve të zgjedhur nga kolegët e tyre", thuhet në raport.



Gjatë një seance parlamentare

Koçi: Kontroll shtetëror mbi transferimin e mallrave ushtarake me përdorim të dyfishtë

Komisioni për Sigurinë Kombëtare shqyrtoi projektligjin "Për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe të artikulave e teknologjive me përdorim të dyfishtë". I pranishëm në mbledhjen e komisionit ishte zëvendësministri i

Mbrojtjes, Petro Koçi, i cili bëri prezantimin e projektligjit. "Kontrolli shtetëror mbi transferimet ndërkombëtare për mallrat ushtarake apo artikujt e teknologjive për përdorim të dyfishtë është një çështje dhe sensibilitet i lartë për sigurinë kombëtare. Sigurisht që vjen si pasojë e një detyrimi ndërkombëtar, pra transferimi i këtyre mallrave është nevojë dhe iniciativë ndërkombëtare, sepse ka qenë gjithmonë e nevojshme për t'u rregulluar. Për pasojë, ky projektligj është në përputhje me detyrimet që ne kemi si anëtar të OKB-së", u shpreh Koçi. Relatori i projektligjit, deputeti Vullnet Sina tha se:



ZËVENDËSMINISTRI

"Kontrolli shtetëror mbi transferimet ndërkombëtare për mallrat ushtarake apo artikujt e teknologjive për përdorim të dyfishtë është një çështje dhe sensibilitet i lartë për sigurinë kombëtare".
"Qëllimi i këtij ligji lidhet mbi vendosjen e kontrollit shtetëror mbi transferimet ndërkombëtar të mallrave ushtarake, artikujve të teknologjive për përdorim të dyfishtë për të siguruar mbrojtjen e interesave kombëtare të Republikës së Shqipërisë, sigurinë dhe politikën e jashtme, kredibilitetin ndërkombëtar të saj, dhe garantimin e respektimit të angazhimeve dhe kontrolleve të Republikës së Shqipërisë në këtë fushë".

të parave dhe konfiskimin e pasurive, si dhe trajtimin e çështjes së financimit të terrorizmit. Autoritetet shqiptare duhet të zbatojnë me shpjëtisi rekomandimet e raportit Moneyval për luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Nevojiten përpjekje të mëtejshme për krijimin e një rekordi të qëndrueshëm të hetimeve, ndjekjeve penale dhe dënimeve përfundimtare në luftën kundër korrupsionit dhe korrupsionit të organizuar. Komisioni, duke kujtuar Konkluzionet e Këshillit të qershorit 2018, që përcaktoi rrugën drejt hapjes së negociatave të pranimit në qershor 2019, përsëriti gatishmërinë e tij për të filluar punën e nevojshme përgatitore që do të përfshijë fokusin në çështjet e shtetit ligjor.

Lartë të Drejtësisë, i cili është i pavarur si autoriteti përgjegjës për trajtimin e ankesave, hetimin e shkeljeve dhe fillimin e procedimeve disiplinore ndaj gjithë gjyqtarëve, megjithëse vë në dukje se postu duhet të plotësohet. Nga ana tjetër, GRECO shpreh keqardhjen për vone-

sat e vazhdueshme në vlerësimet periodike të gjyqtarëve. Për sa i përket prokurorëve, raporti shënon përparim në kuadrin ligjor për vlerësimin e tyre, i cili duhet të përfshijë më shumë kritere lidhur me integritetin dhe standardet etike, edhe pse Këshilli i Lartë

Prokurorial, i cili do të jetë përgjegjës për vlerësimin e prokurorëve, ende nuk është krijuar. Së fundmi GRECO u kërkon autoritetet shqiptare të sigurojnë një përditësim të progresit në zbatimin e rekomandimeve të pa-përmbushura deri më 31 mars 2019, si afat i fundit.



Paralajmërimi i kreut të ILDKP: Në 2019 do të mbetemi pa Gjykatë Apeli

Ganaj: 50% e gjyqtarëve dhe prokurorëve ikin nga pasuria

"Njerëzit e drejtësisë fshehin pasurinë ose deklarime të rreme"

Valentina Madani

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive konstaton se mbi 50% e gjyqtarëve dhe prokurorëve nuk do ta kalojnë vettingun. Para Komisionit të Ligjeve ku prezantoi raportin 1-vjeçar të punës së institucionit që ai drejton, kryetari i Inspektoratit Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, Shkëlqim Ganaj, tha se nga kontrolli i 800 gjyqtarëve dhe prokurorëve rezultoi se mbi 50% e tyre kanë probleme me pasurinë dhe pritet që të shkarkohen nga vetingu. "Të dhënat e para janë shqetësuese. Rezultoni që 50% e tyre të kenë probleme gofhtë për fshehje pasurie, gofhtë për deklarime të



kryetari i ILDKP, Shkëlqim Ganaj, në Komisionin e Ligjeve

për vitin 2017. "Rezultoni që 50% e tyre të kenë probleme, gofhtë për fshehje të pasurive, gofhtë për deklarime të rreme, gofhtë për raste të konfliktit të interesit. Është një numër shqetësues, jashtëzakonisht i lartë. Vetëm për pjesën e pasurisë, aq sa ne jemi të lejuar të bëjmë, shifra është arritur të 50.1%", u shpreh Ganaj. Nëse mbahet ky trend, vitin e ardhshëm vendi mund të mbetet pa Gjykatë Apeli, parashikoi kryeinspektori Shkëlqim Ganaj. "Pjesa e gjyqtarëve të Apelit është pjesa me përqindjen më të lartë të problematikës. Duke parë që Gjykata Kushtetuese është jashtë funksioni, Gjykata e Lartë është me mangësi të mëdha, unë mendoj që vitin tjetër ne do të jemi edhe pa Gjykatë Apeli me këtë trend, që të paktën duket nga të dhënat e para", paralajmëroi kryeinspektori i ILDKP. Deputetët e pyetën kryeinspektorin se si ka mundësi që nga hetimi i komisioneve të vetingu shifra e njerëzve me probleme rezultoi të jetë më e ulët nga sa raporton ILDKP.

JORIDA TABAKU

"Në vitin 2016, vit kur Fusha u bë pronar, Rama e zhvlerësoi pronën nga 1 milionë e 200 mijë lekë për m² që ishte në vitin 2012 në më pak se 670 mijë lekë të vjetra për m². Por mafies Rama-Fusha-Veliasj as kjo nuk i mjafton. Tani kanë nisur të kërcënojnë pronarët e ligjshëm, të cilët nuk duan t'u a shesin pronën me një çmim qesharak një kompanie, prapa të cilës qëndron kryeministri i vendit", tha zj. Tabaku.

KRYEMADHI

Kryetarja e LSI akuzoi Kryeministrin Rama për rrënimin e vendit nga banditizmi i tij. "Askush më parë nuk ka qenë kaq thellë i përfshirë në trafiqe dhe lllumin e bandave. Askush më parë nuk ka qenë kaq arrogant dhe tallës ndaj probleme dhe halleve të shqiptarëve. LSI ka në plan që për 3 muajt të pastrojë Shqipërinë nga droga dhe lllumi i Edi Ramës".

SPAHO

"Grupet kriminale shqiptare janë përhapur gjerësisht ne trafikimin e kokainës nga Amerika e Jugut. Paraja e grupeve kriminale është rritur ndjeshëm dhe ato pastrohen lehtësisht në Shqipëri. Arsyet janë ne kriminalizimin e plote të qeverisjes dhe institucioneve", tha kreu i deputetwve tw PD.

rreme, gofhtë për konflikt interesi", deklaroi z. Ganaj. Kreu i ILDKP shpjegoi edhe arsyet pse prokurorët dhe gjyqtarët të cilët kanë figuruar të pastër në këtë institucion, janë gjetur me probleme dhe shkarkuar nga komisioni i pavarur i kualifikimit. Gjatë raportimit në Komisionin e Ligjeve, kryeinspektori Shkëlqim Ganaj i cilësoi shifra shqetësuese, ndërsa

paralajmëroi se nëse vijohet me këtë trend, në 2019-ën nuk do të kemi më Gjykatë Apeli. Më shumë se gjysma e njerëzve të drejtësisë rezultojnë të mos e kalojnë etingun për shkak të fshehjes së pasurisë apo konfliktit të interesit. Kreu i ILDKP raportoi në Kuvend shifrën alarmante të konstatuar gjatë verifikimit të pasurisë së gjyqtarëve dhe prokurorëve

paralajmëroi se nëse vijohet me këtë trend, në 2019-ën nuk do të kemi më Gjykatë Apeli. Më shumë se gjysma e njerëzve të drejtësisë rezultojnë të mos e kalojnë etingun për shkak të fshehjes së pasurisë apo konfliktit të interesit. Kreu i ILDKP raportoi në Kuvend shifrën alarmante të konstatuar gjatë verifikimit të pasurisë së gjyqtarëve dhe prokurorëve



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

NJOFTIM

PËR ZHVILLIMIN E TENDERIT PUBLIK ME OBJEKT:

DHËNIA E TË DREJTAVE TË PËRDORIMIT NË BREZIN E FREKUENCAVE 800 MHz (792-862 MHz), Ref. 1x10 MHz i çiftuar-800-2018

- Autoriteti përgjegjës:** Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) Rruga "Reshit Çollaku" Tiranë - Shqipëri Tel/Fax: 04 259571/04 259106 E-mail: info@akep.al; Adresa web: www.akep.al
- Lloji i procedurës së tenderit:** "Procedurë e Hapur"
- Objekti i tenderit:** "Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 800 MHz (792-862 MHz), Ref. 1x10 MHz i çiftuar-800-2018".
- Çmimi:**
 - Çmimi minimal i pranueshëm për ofertuesit për të drejtë përdorimi 1 x 10 MHz i çiftuar është **7,440,000 (shtatë milion e katërqind e dyzet mijë) Euro**.
 - Ofertuesit të cilët kanë ofruar ne ofertën e tyre një çmim me të vogël se çmimi i vendosur në kriterin "çmimi minimal i ofertës", do të kualifikohen
- Afati dhe adresa për dorëzimin e ofertave:**

Ofertat duhet të dorëzohen jo më vonë se data **27.09.2018, ora 10:00**, në adresën:

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) Rruga "Reshit Çollaku" Tiranë - Shqipëri
- Data e hapjes së ofertave: 27.09.2018, ora 10:00** Në ambientet e AKEP në adresën: Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) Rruga "Reshit Çollaku" Tiranë - Shqipëri
- Gjuha e ofertës:** Gjuha e ofertës do të jetë gjuha shqipe ose angleze.
- Dokumentat e tenderit** në formë të printuar mund të tërhiqen në ambientet e AKEP, gjatë cdo ditë pune duke filluar nga data 11.07.2018, nga ora 9:00 deri në orën 15:30. Personi që do të paraqitet për tërheqjen e dokumentit të tenderit duhet të ketë me vete dokumentin e bankës që vërton kryerjen e pagesës prej 10 (djetë) Euro, e cila kryhet në një nga llogaritë bankare të AKEP, sipas sqarimeve në Dokumentin e Tenderit.

Dokumentet e Tenderit mund të shkarkohen pa pagesë nga faqja elektronike e AKEP, në adresën www.akep.al.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

PROCEDURË PROKURIMI

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Përzgjedhja e agjencisë së udhëtimit për pajisjen e stafit të Bankës së Shqipërisë me bileta udhëtimi"

'Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Procedurë e veçantë sipas vendimit të Këshillit Mbikëqyrës nr. 65, datë 26.11.2014, i ndryshuar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me fond limit 17.500.000 Lekë".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 4251), çdo ditë nga ora 10:00 - 13:00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktësisht prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 2221; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Përzgjedhja e agjencisë së udhëtimit për pajisjen e stafit të Bankës së Shqipërisë me bileta udhëtimi"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 03 Gusht 2018, ora 11:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

TIRANË - Një 42-vjeçar nga Vlora, i cili ishte shpallur në kërkim ndërkombëtar që prej 10 vitesh ka përfunduar dje në pranga. Bëhet fjalë shtetasin Ylli (Fatmir) Vangjelaj nga Vlora, i cili është dënua për vrasjen e një shtetaseje nga Ekuadori. Ngjarja në fjalë ka ndodhur në Itali në vitin 1999, si porosi e një grupi kriminal. Burime zyrtare nga policia e Tiranës bënë



I arrestuari Ylli Vangjelaj

Dhjetë vite në arrati për vrasjen e prostitutës në Itali, përfundon në pranga vlonjati

me dije se Vangjelaj u kap gjatë operacionit të koduar "Fundi i arratisë". "Me datë 12.07.2018, në sajë të shkëmbimit të informacioneve në kohë rekord midis strukturave të policisë shqiptare dhe asaj italiane, u bë lokalizimi dhe kapja 42-vjeçarit,

banues në Vlorë. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë me shkresën Nr. 3077 të datës 24.04.09 ka dërguar urdhrin për ekzekutimin e vendimit Nr.45 të datës 25.03.09 të Gjykatës së Rrethit Vlorë, e cila e ka dënua me 23 vjet burg, për ve-

prën penale të "Vrasje me dashje kryer në bashkëpunim". Vrasja për të cilën është dënua ky shtetas është kryer në Itali në vitin 1999, si porosi e një grupi kriminal, ku është vrarë një shtetase ekuadoriane e cila dyshohej se punonte si

prostitutë. Ky shtetas i fshihej drejtësisë që prej 10 vitesh duke përdorur gjeneralitetet të rreme. Gjithashtu, u sekuestruan në cilësinë e provës materiale: një automjet i markës "Volksvagen Passat", një leje drejtimi, e cila dyshohet e falsifikuar pasi përmbante gjeneralitetet e të vëllait të personit të kërkuar dhe dy telefona celular", - thuhet në njoftimin zyrtar të policisë.

Drejtori i policisë: Po zbatojmë ligjin për hapësirat publike

Policia e FNSH aksion në Velipojë, sekuestrohen 500 shezlonge pa leje

Kreu i PD-së, Nikollë Marku: Erdhët me urdhër politik. Dhe një vit jeni në pushtet, pastaj vijmë ne



Nikollë Marku gjatë përplasjes me drejtorin e policisë



Shezlonge të sekuestruara

Senad Nikshiqi

SHKODËR

Mbi 150 forca policie të Shkodrës, FNSH, forcat "Shqiponja" bashkë me shërbimet e tjera të komisarariatit kanë zbankuar në orët e para të mëngjesit të djeshëm në plazhin e Velipojës për të liru hapësirat publike të zëna forcërisht në pjesën e rërës. Sipas ligjit në fuqi, 20% e rërës në plazhe duhet të jetë e lirshme për pushuesit. Ndërkohë që në Velipojë edhe kjo hapësirë për çdo vit është zënë forcërisht. Për herë të parë institucionet, të kryesuar nga Bashkia Shkodër dhe policia kanë bashkërenduar punën për lirin e këtyre hapësirave. Aksioni është menduar që të nisë pas mesnate, ndërsa janë hequr 500 shezlonge dhe çadra pa leje. Gjatë këtij aksioni efektiviteti e policisë kanë hasur në rezistencën e pronarëve të bizneseve, të cilët nuk kanë pranuar t'i dorëzojnë objektet. Pronarët kanë kërkuar që policia të mos ndërhyjë gjatë orëve të natës dhe t'i kishte njoftuar ata më parë, ndërsa pretendojnë se kanë aplikuar për leje për shfrytëzimin e territorit në Velipojë, por askush nuk u ka kthyer përgjigje. Një prej debateve më të forta ka qenë ai mes drejtorit të policisë vendore të Shkodrës, Vehbi Bushati dhe kryetarit të PD-së në Velipojë, Nikollë Marku, njëherazi dhe ish-kryetar i ish-komunës Velipojë. Nipat e Markut posedonin shezlonge në Velipojë dhe policia ka shkua aty për shkak se bashkia Shkodër ka patur edhe emrin e tyre në listë si të parregullit. Ndërkaq, ka ndërhyrë kreu i PD-së duke thënë se kjo është e qëllimshme për të goditur Partinë Demokratike. Sipas tij, ky aksion është ndërmarrë në mënyrë selektive duke mos qenë të gjithë të barabartë.

PËRPLASJA (KREU I PD-SË)

"Ju keni ardhur me urdhër politik këtu. Keni ardhur në mënyrë politike. Ju e dini se unë jam kryetar i PD-së. Këtë janë prorat e nipave të mi. Keni ardhur gabim. Nuk mund të sillat policia në këtë mënyrë. Ka ditë boll dhe duhet të vini ditën.

500

SHZLONGE

Gjatë aksionit të ndërmarrë në plazhin e Velipojës janë sekuestruar mbi 500 shezlonge në disa parcela të ndryshme, nga Vilini deri tek plazhi Ada. Një pjesë e shezlongeve janë hequr nga vetë pronarët përpara se të shkonte policia. Ndërsa, janë përdorur mbi 12 kamionë për të ngarkuar shezlonget e sekuestruara. Ky operacion është paralajmëruar nga kryetarja e bashkisë, Voltana Ademi dhe zëvendëskryeminstria Senida Mesi pak ditë më parë. Tashmë duhet pritur nëse këto hapësira që janë liruara a do të zihen sërish apo do të qëndrojnë bosh deri në fund të sezonit.

Duhet të na kishit njoftuar dhe do kishim marrë vetë masat tona, por ju jeni këtu politikisht. Ne e kemi bërë këtë biznes me gjakun e shpirtit. Kemi duruar 50 vite dhe nuk e kemi problem të durojmë edhe 500 vite nga ju. Ju edhe një vit jeni se pastaj do t'i marrim ne fatet e vendit në dorë dhe nuk do sillemi kështu me qytetarët. Kjo është brutale dhe nuk mund të veprojë kështu Policia e Shtetit. Po e bëni në mënyrë selektive dhe këtu jeni me qëllim", ka thënë kreu i PD-së, Nikollë Marku.

DREJTORI I POLICISË

E menjëhershme ka qenë përgjigja e drejtorit të policisë vendore të Shkodrës, Vehbi Bushati, i cili i është përgjigjur Markut se policia po zbaton ligjin dhe se nuk ka asnjë

urdhër politik. "Këtu nuk jemi në miting. Ne jemi Policia e Shtetit. Kemi në dorë një listë me emra që janë të paligjshëm për shkak se nuk kanë dokumentacion dhe listën na e ka dhënë bashkia Shkodër. Jemi për të zbatuar ligjin dhe asgjë më shumë dhe për t'u ofruar të gjithë pushuesve një sezon sa më të mbarë turistik. Nëse e ke biznesin me gjakun e shpirtit, atëherë, ju lutem, ju ftoj që të zbatoni ligjin. Do veprojmë me qetësi dhe kush nuk ka dokumentacion ne do vijojmë procedurat tona. Askush nuk do të tolerohet", është shprehur kreu i policisë Bushati. Në lidhje me aksionin ka debatuar edhe një tjetër pronar në Velipojë. Bëhet fjalë për Agim Plepën, i cili po ashtu është një eksponent në PD-

në e Shkodrës. "Pse nuk vjen këtu kryetarja e bashkisë dhe vini ju? Ju thonë se jeni për të mbështetur bashkinë, po kryetarja ku është? Unë zotëri kam që me 15 maj që kam ap-

likuar dhe askush nuk më ka dhënë përgjigje nëse duhet t'i vendos apo jo shezlonget, mirëpo unë jam pronar biznesi këtu në Velipojë prej vitesh dhe nuk duhet të trajtohem kështu. Askush s'ka ardhur për të matur zonën, askush s'ka ardhur nga asnjë institucion për të parë dhe për ta zgjidhur problemin dhe vini ju tani për t'i sekuestruar. Nuk është normale". Ndërsa drejtori i policisë Shkodër është i prerë në qëndrimin e tij duke thënë se do zbatohet ligji dhe se operacioni do vijojë deri në fund.

613 kg kokainë në Durrës, sekuestrohen llogaritë bankare të kompanive 'Arbri Garden' dhe 'Ecoalmax'

TIRANË - Në vijim të hetimeve për asetet me burim kriminal, pas operacionit "Last Snow" ku u sekuestruan 613 kg kokainë në Portin e Durrësit disa muaj më parë, Task Forca Speciale bëri sekuestrimin e llogarive bankare në emër dhe për llogari të sub-

jekteve "Arbri Garden" shpk dhe "Ecoalmax" shpk. Sipas burimeve policore, vlera totale e sekuestruar është rreth 38 mijë dollarë dhe mbi 10 milion lekë (të reja), që dyshohen si të përfutuara nga aktiviteti kriminal i shtetasve të ndaluar nga Policia. "Departamen-

ti i Policisë Kriminale, në bashkëpunim me Prokurorinë e Krimeve të Rënda në kuadër të operacionit "Forca e Ligjit", po vijon hetimet intensive për këtë grup të dyshuar që operon në fushën e trafikimit të drogave të forta", thuhet në njoftimin e policisë.

SHKURT

Shpërndanin kokainë me motorin e picerisë, 3 të rinj në pranga

TIRANË - Tre pjesëtarë të një grupi të shpërndarjes së lëndëve narkotike në kryeqytet, janë vënë në pranga të mërkurën. Mësohet se tre të arrestuarit Gersi Çeça, 28 vjeç, Renaldo Dalipi, 25 vjeç, dhe Alban Avdo, 27 vjeç, të tre banues në Tiranë, kishin gjetur një mënyrë të veçantë për shpërndarjen e kokainës. Sipas policisë, të rinjtë në bashkëpunim me njëri-tjetrin e shpërndanin drogën me motorin e picerisë ku punonin.

Shfrytëzonte pikën e llotos për të shitur drogë, kapet biznesmeni

KAVAJË - Një pronar i një pike llotosje në Kavajë është arrestuar nga policia për "Prodhim dhe shitje lëndësh narkotike" dhe "Organizim i lotarive të palejuara". Bëhet fjalë për 31-vjeçarin Erti Kadiu, i cili u kap gjatë operacionit të koduar "Basti i Fundit". Mësohet se blutë ishin në ndjekje të Kadiut, pasi disponon informacion se ky shtetas në pikën e tij të llotos ushtronte aktivitet të kundërligjshëm të shpërndarjes së lëndëve narkotike. Gjatë kontrollit të ushtruar dy ditë më parë në pikën e llotos së këtij shtetasi u gjetën doza 21 doza kokainë.

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit: Shoqërohej me një person të dënuar

Vetingu, pasuritë e pajustificuara rrezikojnë gjyqtarin e Kushtetueses, Gani Dizdari

Nuk deklaroi dhurimin e mbi 10 mijë eurove për t'u kuruar në Gjermani, probleme me pasurinë e vajzës

TIRANË

Gani Dizdari është anëtar i fundit i Gjykatës Kushtetuese që po përballlet me vetingun, proces ky që ka rezultuar deri më tani fatal për katër kolegë të tij dhe është kapërcyer nga vetëm dy të tjerë. Mesditën e djeshme u zhvillua seanca dëgjimore për gjykatësin Dizdari, ndërkohë që ky i fundit nuk ishte i pranishëm, por u përfaqësua nga avokati Sokol Azizaj. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit konstatoi pasuri të pajustificuara dhe të padeklaruara nga Dizdari dhe e bija si dhe kontaktet e papajftueshme me nipin e tij të dënuar për ndikimin e një vendimi për vrasje në Gjykatën e Lartë. Trupi gjyqësor, i cili përbëhet nga Pamela Qirko, Roland Ilija dhe Olsi Komici konstatoi probleme si në kriterin e pasurisë, ashtu edhe në atë të pastërtisë së figurës. Ndërsa Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë e kishte certifikuar pasurinë e Dizdarit si të ligjshme, KPK evidentoj burime të pamjaftueshme për një pjesë të pasurisë së gjyqtarit si dhe mungesë burimesh të ligjshme dhe pasuri të padeklaruara në emër të vajzës. Në vitin 2009, Dizdari dhe vajza e tij deklarorin dhurata në vlerën 15.300 euro nga dasma e kësaj të fundit, ndërkohë që nuk deklarohet asnjë shpenzim për dasmën. Ndër të tjera, gjyqtari nuk ka deklaruar as në ILKDPI dhe as në veting, dhurimin e mbi 10 mijë eurove për t'u kuruar në Gjermani. Në vlerësimin e pasurisë së Gani Dizdarit nga KPK është konstatuar, apartament 95 metra katrorë, 24 mijë lekë të blerë në vitin 1994. Apartament banimi të Gjiri i Lalsit 63 metra katrorë plus balkon në total 86 metra katrorë, blerë për 3.3 milionë lekë. Tokë arë në Bathore 1000 metra katrorë blerë 344 mijë lekë. Apartament banimi i bashkëshortes 68 metra katrorë blerë në vitin 1998, por sipas KPK nuk ka pasur burime për ta blerë këtë apartament. Depozitë bankare 1.8 milionë lekë dhe depozitë 8 mijë dollarë. Ndërkohë i rezultojnë një llogari 1.1 milionë lekë në një bankë tjetër.

PASURIA E VAJZËS

Sa u takon pasurive të deklaruara nga vajza e Dizdarit si person i lidhur, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit konstatoi mospërpunje të shumta, mungesë burimesh të ligjshme dhe shmangje nga deklarimi. Sipas relatorit, vajza e subjektit ka blerë një apartament në vitin 2009, por sipërfaqja e tij dhe vlera kanë mospërpunje me deklaratën periodike, deklarata "veting" dhe pyetësorëve. Në vitin 2009, apartamenti është deklaruar me vlerë 94 mijë euro,



Gjyqtari i Kushtetueses, Gani Dizdari

Kalon vetingun prokurori Beluri, që pushoi çështjen ndaj Thanzës

TIRANË - Prokurori i Prokurorisë së Përgjithshme, Kostaq Beluri ka kaluar me sukses në "sitën" e vetingut. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit pas seancës dëgjimore, ka konfirmuar në detyrë Belurin (kandidat për KLP), i cili ka rezultuar pa probleme në elementin e pasurisë. Dy ditë më parë, Beluri ishte në seancë dëgjimore ku kaloi kriterin e pasurisë, por mbeti tek aftësitë profesionale. Problem për prokurorin ishte pushimi i hetimeve për gjyqtarin e Gjykatës së Lartë, Admir Thanza, i cili ishte nën hetim për korrupsion, pasi ishte filmuar duke shkëmbyer para me gruan e një personi në kërkim në vitin 2016. Sipas KPK-së, prokurori Kostaq Beluri nuk ka ndërmarrë hapa ligjorë që të thellonin hetimin, por ka vendosur ta pushojë atë. Dje këtë çështje, KPK vendosi t'ia transferojë prokurorisë për vlerësim.

ndërsa në deklaratën "Veting" për 73 mijë euro. Gjithashtu, burimi i krijimit të kësaj pasurie nuk konsiderohet i ligjshëm. Sipas KPK-së, vajza e Dizdarit ka deklaruar se ka marrë 36 mijë euro borxh në vitin 2009 dhe 20 mijë euro borxh në vitin 2010 nga të afërmit, ndërkohë që 23 mijë euro të tjera i ka paguar ish-bashkëshorti. Hetimi administrativ i KPK-së ka arritur në përfundimin se asnjëri prej të afërmeve nuk kishte burime të ligjshme për huat, ndërkohë që ish-bashkëshorti nuk dispononte dokumentacion për paratë që pretendonte se i kishte fituar nga emigracioni.

NIPI I DËNUAR

Komisioni konstatoi gjithashtu probleme të ardhurash në blerjen e një

makine me vlerë 6 mijë euro. Gjithashtu, komisioni konstatoi se "Dizdari ka kontakte të papërshtatshme me shtetasin A.L. i dënuar për

TIRANË - Katër personat e arrestuar për sasinë monetare prej rreth 3.4 mln euro që u sekuestruan pak ditë më parë në portin e Durrësit, në dy "Toyota Yaris" do të vijojnë të mbeten në burg. Gjykata e Krimeve të Rënda dhe ka rikonfirmuar masën e sigurisë "Arrest me burg" ndaj Edi (Eduart) Lika, pronari i subjektit transportues; djalin e tij Klevis Lika, 19 vjeç e shoqëron drejtuesin e kamionit në

Nuk kalon sitën e vetingut, KPK shkarkon prokurorin Adriatik Cama

TIRANË - Komisioni i Pavarur i Kualifikimit nuk ka rikonfirmuar në detyrë prokurorin Adriatik Cama, i cili nuk e kalon kështu procesin e vetingut. Prokurori i Tiranës, sipas KKP nuk e justifikon pasurinë. Në seancën e djeshme dëgjimore para komisionit të vetingut, Cama tentoi të shpjegojë të gjitha konstatimet e KPK-së për problemet e gjetura në justifikimin e pasurive dhe pastërtinë e figurës. "Ju nuk keni marrë parasysh lidhjet e mia të forta familjare dhe mbështetjen e tyre ndaj meje, që



Prokurori, Adriatik Cama

ka qenë e konsiderueshme. Unë kam qenë prokuror edhe në vitin '97 dhe kam mbrojtur shtetin edhe atëherë kur ai nuk ekzistonte. Sa i për-

ket ndryshimit të prokurorisë në Lushnjë, e bëra pas indicieve se ndaj saj ishte ushtruar presion", deklaroi Cama.

ushtrim të ndikimit të paligjshëm. U tha se Dizdari ka udhëtuar me makinën e shtetasit A.L. (Agron Lumeshi) jashtë vendit, i cili rezultoi të jetë nipi i gjyqtarit. Lidhur me raportet mes Dizdarit dhe nipit të tij të dënuar, Hazizaj pretendoi se vepra penale e ushtrimit të ndikimit të paligjshëm nuk përfshihet në ligjin "Antimafia", ku sipas tij rënditen veprat penale që lidhen me krimin e organizuar. Megjithatë, ai tha se Dizdari e kishte deklaruar atë në formular dhe se duhej vlerësuar për faktin se nuk ndërhyri kur nipi i tij bëri rekurs në Gjykatë të Lartë dhe kjo e fundit ia rrëzoi kërkesën. Mbetet për t'u parë nëse Dizdari do ta kalojë apo vetingun.

Korrupsioni, dënohet me 3 vite burg ish-nëndrejtori i Burgjeve, Iliaz Labi

TIRANË - Gjykata e Krimeve të Rënda ka dënuar dje me 3 vite burg ish-zëvendësdejtoren e Burgjeve, Iliaz Labin, i cili akuzohet për korrupsion me tenderët e ushqimeve në burgje. Po kështu, Labit i hiqet për 5 vite e drejta për të ushtruar funksione publike. Ndërkohë, gjykata ka dhënë 4 vite burg për Shemsi Sinanin, 3 vite për Nexhmi Ballën dhe Ylber Kalanë të akuzuar për korrupsion aktiv ndaj funksionarëve që ushtrorin detyrë publike. Prokuroria kishte kërkuar 5 vite burg për Iliaz Labin, i akuzuar për korrupsion të funksionarëve publikë. Por pavarësisht pretendencës, sipas prokurorisë, Labi kishte fituar statusin e bashkëpunëtorit dhe si i tillë i pezullohet dënimi me burg. Por, Gjykata ka vendosur dënimin me 3 vite burg. Sipas hetimeve, Labi dhe ish-drejtori i Burgjeve, Artur Zoto, akuzoheshin se kishin përfituar 2 milionë lekë nga tenderat e ushqimeve në institucionet e vuajtjes së dënimit. Më 11 maj gjykata shpalli fajtor ish-drejtorin e Burgjeve, Artur Zoto, duke e dënuar me 5 vite burg.

3.4 mln eurot e sekuestruara në Durrës, Krimet e Rënda lënë në burg 4 të akuzuarit

udhëtim; shoferin e kamionit Agim Ceka dhe ndërmjetësin Alban Mollaymerin. Në nisje të seancës, prokurori i çështjes kërkoi që seanca të zhvillohej me detyrë të mbyllura, pasi sipas tij, ka të dhëna që mund të dëmtojnë hetimin, por një gjë e tillë u kundërshtua nga avokati. Masa u veri-

fikua nga Krimet e Rënda, pasi dosja erdhi për kompetencë nga Prokuroria e Durrësit. Sipas hetimeve të deritanishme, 4 personat në fjalë janë pjesë e një grupi të strukturuar, së bashku me dy kushërinjtë e shpallur në kërkim, Alfred dhe Elvis Vladi. Këta dy fundit ishin edhe personat që kishin po-

rositur automjetet në Belgjikë, aty ku dyshohet se mund të jenë ngarkuar edhe paratë. Nderkaq, për rastin e 3.4 milionë eurove, Prokuroria e Krimeve të Rënda ka dërguar letërpasos në 3 shtete, Gjermani, Belgjikë dhe Angli, nga ku pritet të merret informacion i detajuar.

Dosjet e viteve 1993-2008, formulari-tip për informim në lidhje me ecurinë e vendimeve

Ornela Manjani

Pronarët në Korçë, ATP merr në shqyrtim 10 mijë dosje

Problematikat, procedurat për t'u njohur me ecurinë e shqyrtimit

Agjencia e Trajtimit të Pronave publikon listën me 10 mijë dosje ish-pronarësh, që janë në proces shqyrtimi nga kjo agjenci. Kërkuiesit janë në qarkun e Korçës. Në listën e përditësuar jepet numri i dosjes dhe data e aplikimit, gjeneraliteti e kërkuiesit, sipërfaqet e njohura për kompensim, dosjet për pronarët që kanë marrë vendim negativ dhe dosjet që duhet të plotësohen. Dosjet janë të viteve 1993 deri në vitin 2008. Agjencia e Trajtimit të Pronave ka vënë në dispozicionin të pronarëve formularin-tip, "Informacion në lidhje me ecurinë e dosjes", i cili duhet të plotësohet dhe të dorëzohet në 'Agjenci' për t'u njohur me fazën në të cilën ndodhet shqyrtimi i saj. Agjencia Trajtimit të Pronave është e detyruar që brenda 15 ditëve nga momenti i dorëzimit të kërkesës t'i kthejë përgjigje pronarit në lidhje me ecurinë e dosjes.

FORMULARI

Formulari i aplikimit për informacion në lidhje me ecurinë e dosjes është i ndarë në tri seksione. Aplikanti duhet të plotësojë gjen-

eralitet, adresën dhe të jetë i pajisur me mjet identifikimi në momentin e aplikimit. Në seksionin e dytë duhet të jetë përshkruar në mënyrë të saktë se në lidhje me çfarë kërkoh informacion pala e interesuar, në këtë rast pronari që ka aplikuar për kthim e kompensim prone. Dhe në seksionin e fundit janë të specifikuar pesë dokumentet që duhet të disponojë pronari në momentin e aplikimit.

APLIKIMI

Për t'u njohur me ecurinë e dosjes, subjekti duhet të plotësojë dhe të paraqesë dorazi ose me postë pranë ATP-së kërkesën përkatëse me shkrim për informim në lidhje me ecurinë e dosjes, fotokopje të kartës së identitetit, dëshmi trashëgimie

DOKUMENTACIONI QË DUHET TË PARAQISNI

- Formulari-tip
- Fotokopje e kartës së identitetit
- Kopje vendimi nga ish-KKP/AKKP (nëse ka)
- Dokumente të tjera

dhe prokurë të posaçme. Në faqen zyrtare të ATP-së mësohet se subjekti plotëson kërkesën me shkrim për informim në lidhje me ecurinë e dosjes pranë Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun, në 'Agjenci'. Më pas, kërkesa i kalon zyrës së protokollit, e cila pasi e protokollon, ia dërgon të gjitha kërkesat e ardhura drejtorit të përgjithshëm. Kreu i AKKP-ës ia delegon kërkesat sek-

torit përkatës për ndjekje dhe zbatim. Më pas, sektori përkatës përgatit informacionin e kërkuar dhe njofton subjektin. Në përfundim të shqyrtimit, subjekti paraqitet pranë zyrave të ATP-së për të tërhequr shkresën e kthimit të përgjigjes në lidhje me ecurinë e dosjes ose i dërgohet me postë, sipas kërkesës. Aplikimi për kërkesën për informim mbi dosjen nuk ka kosto.

KORÇË

Nr./Dosjes	Rrethi	Emri (Subjekti kërkuies)	Atesia 2	Mbiemri (Subjekti kërkuies)	Sip. E Njohur/ Mosnjohje M2	Problematika
1037	KORÇE	NIKO		MALAVECI		DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431. DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1038	KORÇE	THOMA		NINKA		DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431. DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1039	KORÇE	VANGJEL		BICOLLI		DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431. DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1040	KORÇE	SKENDER		SHAHINASI		DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431. DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1041	KORÇE	PETRIKA		CULE		DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431. DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1042	KORÇE	MERDAN		SHAHOLLI		DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431. DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1043	KORÇE	ADRIANA		TAKE		DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431. DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1044	KORÇE	FLORESHA		KAMENICA		DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431. DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1049	KORÇE	BASHKIM		METKO		DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431. DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1050	KORÇE	YLLI		METKO		DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431. DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1052	KORÇE	NARTE		LENA		DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431. DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1053	KORÇE	PELLUMB		METKO		DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431. DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1054	KORÇE	MEDI		METKO		DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431. DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE

Nr./Dosjes	Rrethi	Emri (Subjekti kërkuies)	Atesia 2	Mbiemri (Subjekti kërkuies)	Sip. E Njohur/ Mosnjohje M2	Problematika
1057	KORÇE	ADEM		COBANI		DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431. DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1058	KORÇE	MIHAL		BOCKA		DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431. DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1059	KORÇE	DITAR		LAKO		DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431. DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1060	KORÇE	IDAET		ISMALANJ		DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431. DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1061	KORÇE	HAXHI		KASMI		DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431. DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1062	KORÇE	EFTIMI		QIRJO		DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431. DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1063	KORÇE	GURALI		BRAUSHI		DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431. DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1067	KORÇE	FATMIRA		CINI		DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431. DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1064	KORÇE	ESENA		CIPI		DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431. DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1065	KORÇE	BIUAR		CIPI		DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431. DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1066	KORÇE	ELORA		LAVDARI		DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431. DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE
1068	KORÇE	AGRON		DHEMBI		DOSJE PA DOSAR. JANE PAISUR ME AKT PERDORIMI SI PUNONJES NE NB NE NE BAZE TE DEKRETTIT 1431. DT 27.03.1996 SKA DOKUMENT PRONESIE

(vijon)

Kolegji universitar "Luarasi" ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me qendrën "Gratë në Shërbim Publik". E frymëzuar nga Kombet e Bashkuara për fuqizimin e gruas, ish-deputetja Mimoza Hajdarmataj ka hapur qendrën "Gratë në Shërbim Publik". Ajo beson se Shqipëria ka gra dhe vajza të afta, kurajoze dhe plot ide. Tek "Luarasi", Hajdarmataj shpreh bindjen se ka gjetur vajza, të cilat janë aset për çdo forcë sferë të jetës. "Nisma konsiston në një thirrje që të gjithë në të bëjmë një pjesë që të krijojmë një databazë me gra që mbarin vlera. Janë të shkolluara, edukuara dhe do jenë ato pjesë e ndry-

Motoja: Të fuqizojmë të rinjtë, gratë dhe Shqipërinë

Kolegji universitar "Luarasi", bashkëpunim me "Gratë në Shërbim Publik"

shimit. Motoja jonë është të fuqizojmë të rinjtë, gratë dhe Shqipërinë", tha Hajdarmataj. Shumëkush e pranon se në Shqipëri shumica e grave dhe vajzave nuk kanë mundësi të promovohen dhe të garojnë me kush të drejta gare, pasi shpesh hasen me mjedis të pafavorshme, madje armiqësore. Këtë e pohon edhe rektori i "Luarasit", profesor Ethem Ruka, por shprehet se kjo qendër është burim frymëzi-

mi për fuqizimin e studenteve. "Komunikoni me studentët, me vajzat e reja që janë pjesë e universitetin tonë, pasi kanë nevojë që të motivohen. Kush shikon gra që janë histori suksesi dhe që se kanë pasur të lehtë të kapin suksesin, shërben si model për një gjeneratë të tërë", tha Ruka. Shefja e departamentit të Ekonomiksit, Aelita Mani, thotë se kjo marrëveshje merr rëndësi të veçantë pasi studentët e "Luarasi" do të inkurajohen për të genë pjesëmarrës në çdo nivel vendimmarrjeje të shërbimit publik. "Studentët tanë, nesër apo sot në bankat e shkollës, mund të ofrojnë kontributet e tyre pse jo duke ndërthurur aktivitetet e qendrës 'Gratë në Shërbim Publik' që ka në fokus të rinjtë dhe të rejtat, me jetën sociale, ekonomike, të studentëve tanë, pranë 'Luarasit'. Aktivitetet dhe marrëveshjet e tilla u japin



rrugë studentëve tanë dhe profesorëve që të japin kontributin e tyre në jetën publike. Në vendimmarrje dhe në shërbim të komunitetit në përgjithësi", pohoi Mani. "Qendra beson se fuqizimi i vajzave dhe grave nëpërmjet

edukimit dhe aftësimin profesional do të ndryshojë Shqipërinë e si pasojë - thotë drejtuesja e qendrës 'Gratë në Shërbim Publik' - do të kemi më pak probleme me dhunën me izolimin dhe me prapambetjen".

Tekstet falas do t'i marrin të gjithë nxënësit e klasës së parë deri në të katërtën

Librat falas, Zamira Gjini: Përfitojnë 125 mijë nxënës

Shpërndarja, në shkolla deri në 17 shtator

Ornela Manjani

Nxënësit që ndjekin arsimin fillor nga klasa e parë deri në klasën e katërt do t'i përfitojnë tekstet shkollore falas. Sipas vendimit të Këshillit të Ministrave, çmimi i blerjes së tyre do të mbulohet 100% nga fondet e buxhetit të shtetit.

TEKSTET

Blerja e teksteve në emër të prindërve për llogari të nxënësve do të kryhet nga institucioni arsimor. Drejtorja e Drejtorisë së Arsimit Parauniversitar pranë Ministrisë së Arsimit, Zamira Gjini, theksoi se shpërndarja do të bëhet në shkollat dhe pritet që për këtë vit shkollor të përfitojnë rreth 125 mijë nxënës. "Tekstet falas do t'i marrin të gjithë nxënësit e klasës së parë deri në klasën e katërt. Janë rreth 125 mijë nxënës, por krahas tyre do të vazhdojnë të marrin tekstet falas edhe të gjithë ato kategori të nxënësve, të cilët i kanë marrë tekstet falas edhe vitet më parë, siç janë kategoritë e nxënësve me aftësi të kufizuara, nxënësit rom dhe egjiptianë, nxënësit që vuajnë paraburgimin, apo edhe kategori të tjera, shtresa sociale, të cilat i kanë marrë tekstet falas, por që u takojnë klasave nga klasa e pestë deri në klasën e dymbëdhjetë", njoftoi Gjini. Ndërkohë, sa i takon likuidimit të faturës tatimore ndaj subjekteve, shtëpive botuese, realizohet nga njësi arsimore vendore, me fondet e miratuara si "Transferti tek individët". Për zbatimin e këtij vendimi është parashikuar një fond prej 270 milionë lekësh, i parashikuar në buxhetin e miratuar në vitin 2018.

VENDIMI I QEVERISË
Nxënësve që ndjekin arsimin fillor nga klasa e parë deri në klasën e katërt u jepen tekstet shkollore në përdorim falas. "Çmimi i blerjes së teksteve shkollore mbulohet 100% nga fondet e buxhetit të shtetit, miratu-



Drejtorja e Drejtorisë së Arsimit Parauniversitar pranë Ministrisë së Arsimit, Zamira Gjini

ar për ministrinë përgjegjëse për arsimin. Institucioni arsimor si dhe njësitë arsimore vendore, brenda muajit korrik të çdo viti përgatisin listën e parashikuar të nxënësve që ndjekin arsimin fillor nga klasa e parë deri në klasën e katërt. Blerja e teksteve shkollore të

nxënësve që ndjekin arsimin fillor nga klasa e parë deri në klasën e katërt, në emër të prindërve ose përfaqësuesve ligjorë, për llogari të nxënësve, realizohet nga institucioni arsimor, për llogari të njësisë arsimore vendore. Likuidimi i faturës tatimore ndaj sub-

VENDIMI

"Tekstet falas do t'i marrin të gjithë nxënësit e klasës së parë deri në klasën e katërt. Janë rreth 125 mijë nxënës, por krahas tyre do të vazhdojnë të marrin tekstet falas edhe të gjithë ato kategori të nxënësve, të cilët i kanë marrë tekstet falas edhe vitet më parë, siç janë kategoritë e nxënësve me aftësi të kufizuara, nxënësit rom dhe egjiptianë, nxënësit që vuajnë paraburgimin, apo edhe kategori të tjera, shtresa sociale,

jekteve, shtëpive botuese, realizohet nga njësi arsimore vendore, me fondet e miratuara si "Transferti tek individët", në buxhetin e ministrisë përgjegjëse për arsimin, në llogarinë bankare të shtetit. Mënyra e shpërndarjes dhe e administrimit të teksteve për këtë kategori nxënësish përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për arsimin", thuhet në vendim. Në pikën dy të vendimit thuhet se efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi parashikohen në shumën prej 270 000 000 lekësh. Këto fonde janë parashikuar në buxhetin e miratuar për vitin 2018, në programin e arsimit bazë 09120, kapitulli 01, në artikullin 606, "Transferti tek individët".

Shërbimi i urgjencës pediatrike në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza" në Tiranë është rindërtuar me standarde bashkëkohore, duke ofruar një standard të ri shërbimi për pacientët. "Po punojmë çdo ditë për të ndërthurur spitalë miqësorë me fëmijët. Sot kemi një urgjencë të re pediatrike, me më shumë hapësira dhe mundësi trajtimi në kushte dhe standarde bashkëkohore për pacientët e vegjël", tha ministria Manastirliu pas vizitës në ambientet e reja të Urgjencës Pediatrike. Manastirliu lajmëroi gjithashtu fillimin e punimeve për rindërtimin

Shërbimi i urgjencës pediatrike, me standarde bashkëkohore

Manastirliu: Spitale miqësore me fëmijët, investimi 8 milionë euro

dhe zgjerimin e Pediatrisë së QSUT-së. "Jemi ambiciozë për të realizuar një ndërhyrje që do t'i ndryshojë krejtësisht pamje Pediatrisë këtu në QSUT, investimi madhor rreth 8 milionë euro në kuadër të projektit të qeverisë shqiptare me Bankën Botërore, që do të rehabilitojë dhe zgjerojë Pediatrinë. Falë kësaj ndërhyrjeje, që do të nisë këtë vit, do të kemi një spital pediatrik modern,

sipas standardeve europiane", u shpreh Manastirliu. E pyetur në lidhje me fluksin në këtë spital, ministria Manastirliu tha se të dhënat e këtij 6-mujori flasin për një ulje të fluksit krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, edhe për faktin se popullata është më e ndërgjegjësuar dhe padyshim shërbimi parësor është përmirësuar. Në urgjencën pediatrike të

QSUT-së, e cila trajton rreth 100 mijë pacientë në vit është ulur koha e pritjes për pacientët e vegjël për arsye të triazhimit, pra diferencimit të rasteve të urgjencave si dhe futjes së sistemit të ri elektronik të menaxhimit të radhës për pacientët. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale deklaroi gjithashtu se do të vijojnë projektet për tjetërsimin e pediatrive



në spitale miqësore, në të gjithë Shqipërinë. Pas Vlorës, Elbasanit së fundi, së shpejti Fierit dhe me fillimin e punimeve për rehabilitimin dhe zgjerimin e Pediatrisë së Durrësit, zgjerohet harta e spitaleve miqësore me fëmijët.

Lista e ALUIZNI-t, personat që kanë ndërtuar pa leje dhe marrin tapitë

Vendimi për tokat e zëna, 900 pronarë përfitojnë kompensim

Pronarët në Berat, Elbasan, Korçë, Fier, Shkodër, Vlorë e Tiranë

Omelia Manjani

Agjencia e Trajtimit të Pronave do të kompensojë 900 pronarë për tokat e zëna në vite nga ndërtimet informale. Vendimi është marrë nga qeveria këtë të mërkurë. "Gazeta Shqiptare" publikon listën me përfituesit në Berat, Elbasan, Korçë, Fier, Shkodër, Lezhë, Vlorë, Tiranë e Gjirokastrë. Zyrtarë Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, të këtyre zonave do të kryejnë ndryshimet përkatëse për këto pasuri në regjistrat e pasurive të paluajtshme, ndërkohë që pronarët që kompensohen duhet t'i nënshtrihen hap pas hapi një serie procedurash, të cilat aktivizohen pas thirrjeve nga ATP. Po ashtu, me vendimin e dy ditëve më parë, janë edhe 30 pronarë që do të marrin certifikatat e pronësisë, emrat e të cilëve janë në fundin e listës që gazeta boton sot. Për të përfituar kompensimin, pronarët duhet të paraqesin në ATP kërkesë për kompensim në vlerë për pronarët e pasur-

ive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimet informale.

DOKUMENTET

Pronari plotëson një kërkesë për kompensimin në vlerë sipas formatit Tip që vëhet në dispozicion nga ATP-ja. I interesuari duhet të paraqesë dëshminë e trashëgimit për të gjithë trashëgimtarët e ligshëm të subjektit përfitues, sipas radhës së trashëgimtarëve, në përputhje me përcaktimet e Kodit Civil. Për dëshmitë e trashëgimit të lëshuara nga gjykata për testamentin e bërë me akt notarial të sille certifikatë familjare e per-

sonit, për të cilin është lëshuar një dëshmi trashëgimie. Kjo tjetër dokument është vërtetimi i lëshuar nga banka e nivelit të dytë për hapjen e llogarisë bankare në emër dhe për llogari të subjektit përfitues, ku përcaktohet edhe numri i llogarisë bankare ku do të transferohet vlera financiare e përfituar. ATP kërkon fotokopjen e dokumentit të identifikimit dhe certifikatën familjare të kërkuarit dhe mandatpagesën, që vërteton pagimin e tarifës së shërbimit. "Duke qenë se ky proces nuk është i kushtëzuar dhe i limituar në kohë, ATP fton të

gjithë subjektet përfituese pas datës 18 qershor që të paraqiten pranë sportevele të saj për të aplikuar, me qëllim përfitimin e kompensimit të miratuar. ATP, në varësi të të ardhurave të arktuara deri me sot për këtë proces nga ALUIZNI dhe fondeve të vëna në dispozicion nga buxheti i shtetit, sipas përlogaritjeve përkatëse shpërndan aktualisht 70% të vlerës së miratuar në VKM për subjektet përfituese", është rregullit që ndjek ATP për këtë rast. Kalimi i pronësisë për 30 përfituesit në Tiranë, procedurën për marrjen e tapisë ndiqen nga ALUIZNI, i cili

dorëzon dosjen e plotë në hipotekë, por pronarët duhet të shkojnë në Zyren e Regjistrimit të Pasurive të aplikojnë për tapinë. Pas ndryshimeve të fundit ligjore, qytetari do të marrë një kopje për të vërtetuar marrimin e procesin të legalizimit, por gjithë procedura vijuese për regjistrimin në Zyren e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme do të bëhet nga Agjencia. Ndërkohë që sipërfaqja e parcelës për të cilën miratohet kalimi i së drejtës së pronësisë, nuk mund të jetë më e madhe se trefishi i sipërfaqes së bazës së ndërtimit dhe për ndër-

timet pa leje me funksion banim jo më shumë se 500 m². Sipërfaqet mbi masat e përcaktuara në këtë pikë, të cilat për shkak të përmasave ose konfiguracionit nuk mund të shfrytëzohen më vete për ndërtim, i shiten poseduesit të ndërtimit pa leje sipas vlerës së pronës, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, vetëm nëse ka shprehur më parë vullnetin, nëpërmjet një kërkesë me shkrim. Ndërsa në rastin kur ndërtimi pa leje disponohet nga më shumë se një person fizik ose juridik, regjistrimi i pjesëve takuese mbi pasuritë (parcelë dhe objekt) kryhet: në pjesë të pandara, ideale, sipas numrit të subjekteve; në pjesë takuese të ndara, sipas marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet subjekteve lirish dhe të depozituar brenda afatit të vetëdeklarimit. Subjektet mund të përcaktojnë përveç pjesës takuese, edhe pjesët fizike respektive nëse ndërmjet tyre përputhet vullneti.

900 PRONARË PËRFITOJNË KOMPENSIM

TIRANË			VENERANDA KOL			ZAMIR FETI			TAPA			BUKURIJË RAHMAN			KAPLLANI			NEXHMIJE			SUBASHI																																																																																																																																																																																																																																							
BAJRAM SELIM CANI	SHEMI MUSTAFA HOXHA	LULEJETA TON KOVACI	FERID REXHEP BERBERI	ELONA ILIR ZACAJ	NDRIMIC LUTFI LLOCI	ISMAIL HASAN BUCUPAJ	HEKURAN LUTFI LLOCI	EDISON BAPTJAR VISHA	MANUSHAQE BAJRAM KODRA	PASHK DED BRUKA	KASTRIOT ISLAM CUKA	LUAN ISLAM CUKA	FATOS ISLAM CUKA	THOMA FORE ZYBA	RAJMONDA MALIQ ZYBA	BARDHOK FJETER GJONJETRI	EMNOR NILAS KALA	ALBERT RAMIZ DUDA	PERPARIM SABRI SALLAKU	BESHNIK ISUF KOTARJA	RUZHDI LIK XIHAPA	ASTRIT BAKI GAGUSHI	XHEMAL QAZIM KODRA	SIMON GJIN DODAJ	BLERIM IMER MASHA	FLATUN KORB BENACA	GURALI TELHA DAUTLLARI	QEMAL SHAQIR KOCI	ERALDO QEMAL KOCI	ASTRIT OSMAN BALLA	EDUART TAHIR NURI	HAXHI MUHARREM SALLAKU	VESEL RAMAZAN HOXHA	ARBEN RAMAZAN SALLAKU	ELIS QEMAL KODRA	PRENG QERIM DOCI	SHKELQIM DEMIR FUSHA	SHABAN ARIF HAXHIAJ	HASIM XHAFERR CENI	LULEZIM GANI KODRA	ERVIS ENVER KORTESHI	ARBEN BANUSH PICI	RUZHDI IP DACI	NDUE GJON NIKOLLI	ARZEN NAZIF MILA	FATMIR SHEPQET RUCI	ANTON GJON PICAKU	ADAM ANTON PICAKU	ISMAIL AHMET VAKA	NUREDIN JAHJA KANAPARI	RINOR MENTOR BEQIRI	MENTOR BEZAT BEQIRI	PETRIT ALI HIDRI	SHKELQIM ISUF BULKU	RAKIP HAJRULLA KORRIKU	ALTN SHKURT ALLBANI	NDOCNDUE MARKU	AGIM NEZIR ALLDERVISHI	CLIRIM FERHAT MUCA	JORGO KOCO DEDE	GANI ABDULLA BRAHJA	ILIR BAJRAM TABAKU	REXHEP KASEM RROSHI	XHEVAHIR HIDAJET SHEHU	FREDI HIDAJET SHEHAJ	XHEVAHIR RRAUSH BRAIMILLARI	SHKELQIM FEZULLA HETA	ASTRIT FEZULLA HETA	LUFTAR ZYBER VESELI	HALLI ALI KOLOSHI	BUJAR YMER VISHA	LATIF HYSEN VISHA	ZLJA KAPLLAN CEKA	MYZEJEN SULEJMAN BILBILI	FATMIRE RAMDAN COLLAKU	ALI RAMAZAN DEMA	ALMA RAMAZAN PINARI	ALBI PELLUMB PINARI	EDUART RAMAZAN DEMA	ENGJELUSHE ENVER GOSTIVARI	GAZMEND ALI GOSTIVARI	SHKELQIM ALI GOSTIVARI	LEDINA ELMAS KABASHI	XHEVDET ELMAS CEBALO	ALMA ALI SPAHIU	AIDA ALEKSANDER BUSHATI	ILIRJAN KOL BUSHATI	ERVIN ALFRED BUSHATI	VIOLICA MYFTAR BUSHATI	GJERGJ ALFRED BUSHATI	ALBENS ALEKSANDER BUSHATI	NAIM RAMAZAN LEKA	VILMA BARDHYL LEKA	ALEKSANDER NACI	AMALIA HIDO	KLODIANA PANDO	IRENA VANGJEL LUBONJA	BERAT ALKETA REFAT ÇOBO	YLLI HAMET SELAMAJ	YLLI HAMET SELAMAJ	HAMET DASHMIR SELAMAJ	SAFET BEKTHAS TOMORI	NURI RAMADAN ÇOBO	FLORIANOROLANDO STEFANI	MARJANTHI ZOI	STEFANI GENCI AMET BERBERI	KASTRIOT FAIK TAIFI	FERDINAND SHABAN KURTI	RENATO XHEMAL QEVANI	XHEMAL SAMI QEVANI	XHEMAL SAMI QEVANI	MIRJAN FEJZI KOXHAJ	HAXHI TOFIK FISKA	SOKOL FASLLI MEMA	AGIM KASEM MERKAJ	ENTILJANO GRANIT SPAHIU	XHEVAIR IZET TABAKU	LAVDOSH ILMI ADERI	NOVRUS AVDULLA KËRKUTA	ILIR NEHAT KALLUÇI	ALGEN GËZIM BAZAJ	PETRIT ADEM BAHO	KUJTIM NAZIF ZYLALI	GEZIM NALIM QAMO	KREAR MUÇO KAPEDANA	EDUART AVDURAMAN KOLONJA	SOKRAT THIMI DHANA	HAJREDIN ELMAS LYBE-	KOSTA HAMZA RUÇI	SEFEDIN MYRTEZA DOKO	ZAMIR FETI TAPA	DIBËR PAJTIM MEDI MEDIU	Aslan Bardulla Shehu	Arben Shuaip Besri Nerulla Shehu	Drita Rexhep Shehu	Tomor Shuaip Shehu	Xhelal Shuaip Shehu	TAJAR BEHXHET HOXHA	YMER SHYQYRI SHKEMBI	FLORENT SKENDER TAPA	SONILA JEMIN TAPA	GEZIM KADRI QEVANI	SELMAN BIDO DEDJA	ZEDEF YEZIR HOXHA	FASLLI SABRI RAGA	NKO FASLLI RAGA	ALFRED FASLLI RAGA	QAMIL YEZIR METUSHI	RUSHIT YEZIR METUSHI	GAZMIR RIZA XIBRRAKU	LUAN ISUF MYZEQARI	ELTON FATMIR XHELILI	AVNI IDRIS BAKU	APOSTOL MITËR SHQAU	XHULEJTA VENEMIN SHQAU	RRAPUSH LLMAN BUZANI	LLAZAR VANGJEL BEZHANI	XHEVDET JANUZ SHABANI	XHAFERR HALIL PISHA	EMILJAN NAZMI ZEJNELI	EDMOND ZEQIR ÇARKU	LEONARD ZEQIR ÇARKU	PETRO MIHAL SINANI	HYQMET LIMON BRAGJEÇI	ILIR ISMAIL KILLOGRI	PERPARIM JOSIF ÇAKALLI	AGRON VEJZ MUÇA	KAPLLAN XHEMAL LLESHI	NAZMI GANI HOXHA	SKENDER KASEM ÇARKU	ANDREA YZEDIN SHAHINI	SHKELQIM ISLAM ELEZI	MERITA NEZIR ELEZI	BEXHET TEFIK KAPLLANI	OSMAN YMER JAZO	ERMIRA FADIL JAZO	SHAZIVAR MASAR KARAO-MANI	SHEGUSH MASAR KOSOVA	FATBARDHSAMI DOKO	ARBEN SAMI DOKO	NESEFJE TEKI SELENICA	BULENT TEKI TELA	EDMOND TEKI TELA	AGRON TEKI TELA	GJERAK MAZLLEM	FELATUN MAZLLEM	KARAIKAJ NEBI ISMAIL SEFA	HAJALI ISMAIL YPI	XHANETA ISMAIL PRODANI	SUHELA XHEVDET LIHOHOVA	TEUTA SKENDER FORA	ILAVDJE SKENDER KALASA	ADEM BAKALLI BAKALLI	DELIMET MEHMET BANGA	HEDJEG LEKA	XHULJETA LEKA	(TREPENISHITI) ARBANA LEKA	(GRECA) CENO METUSHI	EDIS CENO METUSHI	SABRIJE VOGLI VOGLI	KAROLDA ALI VOGLI	MIRELA ALI DOCI	MERITA BESIM IPEKU	ARDJAN MEHMET IPEKU	LUELDA RAMIZ IPEKU	MEHMET IPEKU	FATMIRA XHAFERR IPEKU	ILIRJAN REXHEP LEKA	ALI MUSTAFA SUBASHI	ISMAIL MUSTAFA SUBASHI	ALEMSHA SUBASHI	MANUSHAQE SUBASHI	SUBASHI	SUZANA NAZMI FATUSEH DURIM SHPRESA ERMIRA SUBASHI	BESA SUBASHI	MAHMUT HASTOPALLI (TELA)	FATME HASTOPALLI (TELA)	SHKENDI RUSI	LUAN BAHOLLI	TEFTA BAHOLLI	NAZIF BAHOLLI	SKENDER BAHOLLI	LAVDJE SERJANI	GAZMEND HASEKIU	IBRAHIM HASEKIU	ARDJAN HASEKIU	FAIK SINANI	MEHMET GRACENI	VJOLLCA PAPANHITRI	ILIR GRACENI	ULIS HASTOPALLI	JETA BASHA	ENGJELL DAKU	ARJANA PAPAMIHALI	RIZA ÇIPTJA	ZYRA MALUCA MAKENSEN BUNGO	ATILJE BODINAKU	SHYQYRI HYSKJIA	LORETA HYSKJIA	HYSEN HYSKJIA	FERIJE BYLYK-BASHI	ADRIANO HASTOPALLI	ORNELA HASTOPALLI	Servete Fiqiri Dyrmmishllari	Fedane Fiqiri Qorri	Mirjete Fiqiri Qorri	Diana Fiqiri Qorri	Aslan Fiqiri Qorri	Perparim Fiqiri Qorri	Bukurije Fiqiri Qorri	Mesare Fiqiri Qorri	Servete Fiqiri Dyrmmishllari

Përmbaruesi Gjyqësor Privat Z. Medar Kajolli, njofton shpalljen për shitje në ankand të parë për pasuritë e paluajtshme si më poshtë:

- Pasuria Nr. 250/3+1-2, Vol.-31, fq.-234, Z.k.-1791, Apartament me Sip.-209.7 m², ndodhur në Golem, Kavajë, me vlerë 7549200 Leke.
- Pasuria Nr. 250/1+3, Vol.-31, fq.-235, Z.k.-1791, Apartament me Sip.-209.7 m², ndodhur në Golem, Kavajë, me vlerë 7549200 Leke.
- Pasuria Nr. 211/1, Vol.-4, fq.-201, Z.k.-1791, Iloji Tokë-Oarë me Sip.-500 m², ndodhur në Golem, Kavajë, me vlerë 400000 Leke.

Ankand për pasuritë e mësipërme zhvillohet në datë 12.07.2018 në orën 16.00, në ambientet e zyrës së Përmbaruesit Gjyqësor Privat Z. Medar Kajolli, me adresë: Rruga "Uran Pano", Pll.-1/3, Kati -2, Tiranë. Cel. 069 73 23 003, email: medar.kajolli@yahoo.com

SHPLLJE ANKANDI

Zyra Përmbarimore "E. G. Bailiff Service" me përmbares Enuar Merko me adresë Rr. Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyrja 8, Ap. 1, Tiranë, njofton se me datë 07.08.2018 ora 8⁰⁰ - 16⁰⁰ në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankand i II për shitjen e pasurisë të paluajtshme Trulli me sipërfaqe totale 500 m² nga e cila Ndërtëse me sipërfaqe 123 m², regjistruar në Z.V.R.P.P. Durës me Nr pasurie 7267, Vol.3, Fq.189, Zk.1242 në pronësi të Z.Sali Ibrahim Janku me vlerë fillestare në ankand 90,048 (Nentëdjete mijë e dyzet e tete) EURO. Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, 355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com

Shitje me Ankand të Pare nga Studio Përmbarimore L.D.C

-Apartamenti me nr. 2/260+2-6, vol 30, faqe 140, sip. 104.12 m², ZK 8330, regjistruar në Z.V.R.P.P. Tiranë. Çmimi fillestar për shitje është 6.413.792 Leke.

Data e shpalljes 27.06.2018
Data e zhvillimit 20.07.2018 deri në orën 16.00

Ankand zhvillohet në ambientet e Studios Përmbarimore L.D.C me adresë Rruga "Myslym Shyri" Vila 8/1, kati 1 Tiranë.

Fedane	Fiqiri	Qorri	TOM KOL ULAJ	LIRIJE	SPAHIU	PETRIT	KAPLLAN	LUZI	EDUART	AVDURAMAN	FATIME	HASTOPALLI
Mirjeta	Fiqiri	Qorri	KOLEMARK	ALI	SPAHIU	XHEVAHIR	ASLLAN	BRATI	KOLONJA		SHKENDI	RUSI
Diana	Fiqiri	Qorri	INDRIT	ISA	SPAHIU	ILIR	ASLLAN	BRATI	SOKRAT	THIMI	LUAN	BAHOLLI
Asllan	Fiqiri	Qorri	DIELE DED	DILAVER		ZAMIR	ASLLAN	BRATI	HAJREDIN	ELMAS	LYBE-	TEFTA
Perparim	Fiqiri	Qorri	ALBERT GJEK	KASHAR	KOMUNITETIMYSLIMAN	ASLLAN	HALLI	BRATI	SHARI		KOSTA	HAMZA
Bukurie	Fiqiri	Qorri	EDISON GJEK	KASHAR		LUTFI	MUSTAFI	MEMA	SHARI	HAMZA	RUÇI	NAZIF
Mesare	Fiqiri	Qorri	ENGLAIDA GJEK	SAMI RAMADAN	NELA	NEXHAT	BAJRAM	SHEHU	SEFFEDIN	MYRTEZA	DOKO	SKENDER
KORÇË			GJEK DED DEDA	ARJAN RAMIZ	DALLASHI	RENATO	TOMA	THAKA	ZAMIR	PETI	TAPA	LAVDLJE
HEKURI	SHEFKI	PEPI	MANUSHAQE TOM	SEIT SHABAN	DAMLJANI	GENTJAN	THOMA	THAKA	PAJTIM	MEDI	MEDIU	GAZMEND
HEKURI	SHEFKI	PEPI	ORIEL TOM	YLLI AHMET	GURRA	EDMOND	LIGOR	OGRENI	Asllan		Bardulla	IBRAHIM
MARIGLENHEKURI	PEPI		TONE GJON	ISMAIL RAMAZAN	GURRA	ADEM	NEXHIP	LICAJ	Arben Shuaip		Shehu	HASEKIU
MaksiMiti	Qirici		ARBEN VELI	SHERIF HAXHI	GURRA	HELDON	NEXHIP	LICA	Basri Nerulla		Shehu	HASEKIU
LUSHNJË			PAL FRROK	SULEJMAN KASEM	GURRA	ZEMAN	HABIP MERKOHASANI		Drita Rexhep		Shehu	FAIK
ARJAN	FEJZI	LIKJA	PAL FRROK	FEJZULLA HAZIS	GJOSHI	VASIL	DAUT	KASA	Tomor	Shuaip	Shehu	MEHMET
VESEL	MUSTAFA	LIKJA	LAC LAZER	LUAN SUBI DOBI		BAJRAM	SELIM	CANI	Xhelal	Shuaip	Shehu	GRACENI
NABILE	MUSTAFA	LIKJA	YLLI HAMZ	ABAZSULEJMAN	QORDJA	SHEMSI	MUSTAFA	HOXHA	TAJAR	BEHXHET	HOXHA	ULIS
SABJUE	MUSTAFA	LIKJA	LULJETA SHEFQET	ILIR SULEJMAN	QORDJA	LULJETA	TUN	KOVACI	YMER	SHYQYRI	SHKREMBI	HASTOPALLI
BALLKEZE	HAZIS	LIKJA	YLLI HAMZ	FATMIR SELIM	NDRUJ	FERID	REXHEP	BERBERI	FLORENT	SKENDER	TAPA	JETA
MUSA	HAZIS	LIKJA	DRITAN SEFJAN	VALBONA, AGIM RIZA	KOPANI	ELONA	ILIR	ZACAJ	SONILA	JEMIN	TAPA	BAHOLLI
NIGJARE	HAZIS	LIKJA	JULJAN SEFJAN	KOKOKOCI ZYLFO		NDRICIM	LUTFI	LLOCI	GEZIM	KADRI	QEVANI	BAHOLLI
HANE	LIKJA		SOFIE LUF	SULEJMAN KADRI	GOGA	ISMAIL	HASAN	BUCPAPAJ	SELMAN	BIDO	DEJUA	BAHOLLI
BEHAR	HAZIS	LIKJA	DRITAN SEFJAN	KORAB, TOMORR AVDI	JATA	HEKURAN	LUTFI	LLOCI	ZEDEP	YZEIR	HOXHA	BODINAKU
AZIS	FEJZI	LIKJA	JULJAN SEFJAN	TEFTA	DYLBER	META	EDISON	BAFTJAR	FASLLI	SABRI	RAGA	SHYQYRI
ROLAND	FEJZI	LIKJA	SOFIE LUF	NDUE MARK	PALOKA	MANUSHAQE	BAJRAM	KODRA	NKO FASLLI	RAGA	RAGA	HYSYKJA
SHKODËR			ANTONETA GJETO	MIRI	BESNIK XHEMAL	PASHK	DED	BRUKA	ALFRED	FASLLI	RAGA	HYSYKJA
GJELOSH	LULASH	LAMTHI	DONIKA GJETO	LOSHI	SELM XHEMAL	TRESA			QAMIL	YZEIR	METUSHI	BYLYK-
RUZHDI	RIFAT	VRANJA	DRANE MARK	GJONAJ	DASHMIR NEBI	NIKA			RUSHIT	YZEIR	METUSHI	BASHI
ISMAH	ISMAIL	HOTI	FLORINTE GJETO	LUCA	AGRON FADIL	META			GAZMIR	RIZA	XIBRRAKU	HASTO-
ISMET	FADIL	HOXHA	GJERGJ MARK	LUCAJ	SHKURT EMERLLA	IBRALJI			LUAN ISUF	MYZEQARI		PALLI
GLITON	FADIL	DIBRA	KOLE MARK	LUCAJ	BUJAR TAHR	DRITA			ELTON	FATMIR	XHELILI	HASTO-
SHKELQIM	ISMET	XHAFFERI	LLESH MARK	LUCAJ	ASLAN	BAJRAM	HASA		BARDHOK	PJETER	GJONPJETRI	BAKU
GLEDIS	BASHKIM	HALLUNEJ	MARE DED	MARTINI	GJULSIM MURAT	AHMATI			EDMOND	NJAS	KALA	SHQAQ
OREJETA	QEMAL	HALLUNEJ	NDUE GJETO	LEKAJ	YLLI BASHKIM	ALLUSHI			ALBERT	RAMIZ	DUDA	SHQAQ
MARSIDA	BASHKIM	HALLUNEJ	PRENG GJETO	LEKAJ	YMER ISLAM	GRORI			PERPARIM	SABRI	SALLAKU	BUZANI
AKUB	ASIMBEHRI		VESEL GJETO	LEKAJ	DEJE KASEM	TUJANI			BESNIK	ISUF	KOTARJA	BEZHANI
SHAQIR	RUZHDI	ARKIVANI	VARANIKOLLE	LULAJ	RIZA MEHMET	DALLASHI			RUZHDI	LIX	XHAFA	SHABANI
YLLI	GAFURR	MUÇA	VERONIKA GJETO	DUÇI	AGRON GARIP	BANUSHI			ASTRIT	BAKI	GAGUSHI	PISHA
DORIAN	SHYQYRI	NEZIRI	MIRASH GJOR	THERCAJ	AGIM NURI HYSO				XHEMAL	QAZIM	KODRA	ZEJNELI
VEHBI	HASAN	TRUNGAJ	KANTO MIRASH	THERCAJ	ASTRIT	RAMADAN	MUA		SIMON	GJIN	DODAJ	ÇARKU
ARTUR	MARK	GJONAJ	ZEF MIRASH	THERCAJ	NAZIF VELI	MENA			BLERIM	IMER	MASHA	ÇARKU
KRENAR	BESHO	MATUKA	PJERIN MIRASH	THERCAJ	FATMIR	IMER	ALUSHI		FLATUN	KORB	BENACA	SINANI
FIQIRI	XHELAL	XHAFFERI	MANE MIRASH	THERCAJ	PILLUMB	JEMIN	HALLAJ		GURALI	TELHA	DAUTLLARI	BRAÇEJCI
AFERDITA	MYFIT	XHAFFERI	GJON MIRASH	THERCAJ	GJIN NDUE	MYFIT			QEMAL	SHAQIR	KOCI	KILLOGJRI
ASTRIT	FERIK	LIKJA	LEC MIRASH	THERCAJ	LMAN	SADIK	LALA		ERHALDO	QEMAL	KOCI	ÇAKALLI
ERVIS	FERIK	META	JETA MIRASH	THERCAJ	GANI	LMAN	LALA		ASTRIT	OSMAN	BALLA	MUÇA
LEZHE			EVITA	VIKTOR	SADIK	LALA	LALA		EDUART	TAHR	NURI	LLESHI
GJON	MHILL	LLESHI	ARMANDO VIKTOR	THERCAJ	NASLJE	LIJAN	TANUSHI		HAXHI	MUHARRREM		HOXHA
MRIKE	NIKOLL	PRENGA	MARIOS VIKTOR	THERCAJ	ERMIR	SELMAN	TAPA		SALLAKU			ÇARKU
ZEF	EJELL	GAZULLI	PJETER ZEF	PRENDI	SHEPIT	SHABAN	DUKA		VESEL	RAMAZAN	HOXHA	SHAHINI
GAC	PASHUK	GAZULLI	FRANGJON	TOMA	LUTFI	HASAN	LITA		ERLEN	RAMAZAN	SALLAKU	ELZEI
GLEN	TOM	DEDA	LIUJGJ	KOL	FERAT	BAJRAM	THIKA		ALIS	QEMAL	KODRA	ELZEI
LLESH	PREÇ	COLI	FRANGJON	TOMA	REXHEP	SADIK	LIPO		PRENG	QERIM	DOCI	BEKHET
DODE	PREÇQOLI		LIUJGJ	KOL	ERMIR	RAMADAN	DOGJANI		SHKELQIM	DERIF	FUSHA	KAPLLANI
ZEF	NDUE	KALAJ	LAC LAZER	GEGA	GERMIR	MUSA	KACA		SHABAN	AMIR	HAXHIJAJ	KAPLLANI
VALENTIN	GEG	SMACI	HYSNI ALI	ELEZI	ELTON	HAJREDIN	TOTA		HASIM	XHAFFERR	CENI	JAZO
FRAN	GJERGJ	GERA	FATJON ALI	ELEZI	NDUE	PJETER	VATNIKAJ		LULEZIM	GANI	KODRA	MASAR
ALVIN	ZEF	NDOKA	HYSYEN ALI	ELEZI	EMILJAN	FLAMUR	XHOLI		ERVIS	ENVER	KORTESHI	KOSOVA
MARTIN	PJETER	KOLA	LILJANA ALI	ELEZI	FLAMUR	RUZHDI	XHOLI		ARBEN	BANUSH	PCICI	DOKO
ARMANDO	PJETER	NOKA	XHEVAHIER	ALI	FATMIR	HAMIT	KOTARJA		RUZHDI	IP	DACI	DOKO
LEK	NIKOLL	PRENGA	ELEZI (MAÇOVILA)		NURI	IDRIZ	KANI		NDUE	GJON	NIKOLLI	DOKO
DRITAN	GJON	CEKA	HYSNI ALI	ELEZI	BESHIR	MASLLAM	DOCI		ARBEN	NAZIF	MILA	TELA
ELVIN	GEZIM	CARA	FATJON ALI	ELEZI	ARBEN	GJON	PALLUCA		FATMIR	SHEFQET	RUCI	TELA
FRAN	MARK	KOLA	HYSYEN ALI	ELEZI	RRAHMAN	ALI	HATA		ANTON	GJON	PICAKU	TELA
BARDHYL	FRROK	PACI	LILJANA ALI	ELEZI	DAUT	RRAHMAN	HATA		ADAM	ANTON	PICAKU	MAZLLEM
PASHKO	RROK	DEDA	XHEVAHIRE	ALI	AVNI	ALI	HATA		ISMAIL	AHMET	VAKA	KARAIKKAJ
DENIS	VASIL	PJETRUSHAJ	ELEZI (MAÇOVILA)		LUTFI	AVNI	HATA		NUREDIN	JAHJA	KANAPARI	FELATUN
TOM	SIMON	PJETRUSHAJ	RIDIGER HYSNI	ÇOKAJ	VAHT	AVNI	JONUZI		RINOR	MENTOR	BEQIRI	MAZLLEM
NIK	DED	PERAJ	MARK	NIKOLL	ASTRIT	AHMET	KECAJ		MENTOR	BEZAT	BEQIRI	NEBI
NIKOLL	GJON	FILIP	FAHRIJE	MEM	ARJAN	AHMET	SUCI		PETRIT	ALI	HIDRI	SEEA
PJETER	MARK	MARKU	VERANIKOLL	FRROKU	PELLUMB	AVDYL	BREGU		SHKELQIM	ISUF	BULKU	PRODANI
LADOVIK	PREK	VATAJ	AGRON PAL	KOKAJ	LIJAN	ARIF	MARKU		RAKIP	HAJRULLA	KORRIKU	LIBOVOVA
EDUART	RROK	PEMAJ	HALIT CAN	AVDIJA	MERITA	ISAK	GJABRI		ALVIN	SHKURT	ALLBANI	FORA
LEON	NDREK	MARKU	FATJON PAL	LEKGEKAJ	HIL	TOM	ALLIA		NDONDUJ	MARKU		KALASA
LEON	ZEF	NDOCI	ELEZ SHERIF	DUNGAJ	MAN	SHEMSI	GERBOLLI		AGIM	NEZIR	ALDERVISHI	BAKALLI
ALFRED	LEK	NDOKA	VIKTOR GAQIKUMARAKU		NIKOLL	NDUE	MALSHI		CLIRIM	FERHAT	MUÇA	BAKALLI
TEODOR	MARK	PERLLESHI	VITOR ZEF	DUSHI	LUFTIM	ZYBER	KOZI		JORGO	KOCO	DEDE	BANGA
ALBERT	DOD	KQIRA	NIKOLL PAL	PRENGA	RAMAZAN	SINAN	MUSTEQJA		ALKETA	REFAT	COBO	LEKA
ZEF	NDREK	FILIP	ALVIN HYSYEN	SULAJ	ARIF	BALI	GELAJ		YLLI	HAMET	SELAMAJ	LEKA
DILE	FRROK	FILIP	BESAR	SERVET	ENVER	HAZIR	LIKA		YLLI	HAMET	SELAMAJ	LEKA
PETRIT	ZEF	FILIP	PREL KOLEC	TOMA	GJIN	PREK	BICUKAJ		HAMET	DASHMIR	SELAMAJ	LEKA (GRECA)
KOL	PASHK	GEGA	KRISTINA	MARK	GJIN	PREK	BICUKAJ		SAPET	BEKTASH	TOMORI	CENO
PETRIT	PRENG	PERGJIVUKA	NDUEHILE	BUSHI	DESTAN	RIZA	TOTA		NURI	RAMADAN	COBO	METUSHI
GEZIM	PRENG	PERGJIVUKA	NIKOLL	GJON	PREKA	SHEZE	HYSYEN	SULKAJ	FLORJAN	OROLANDO	STEFANI	VOGLI
DED	SIMON	CELAJ	NIKOLL	GJON	PREKA	ASQIRI	BEKTASH	SULKAJ	MARJANTHI	ZOI	STEFANI	VOGLI
TONIN	DED	CELAJ	RAUF SHABAN	MLIKA	FATMIR	HAZIR	KASTRATI		GENCI	AMET	BERBERI	DOCI
MARGERITA	DEDE	LULGJURAJ	LUL SHABAN	MLIKA	FATMIRE	QAZIM	LUSHA		KASTRIOT	FAIK	TAPI	DOCI
ILIR	KOLE	MARKU	SKENDER	QAMIL	SAMIR	RRAHMAN	DISHA		FERDINAND	SHABAN	KURTI	DOCI
PRENG	GJIN	PREKA	SHABAN	MURATI	ASLAN	AHMET	DOCI		RENATO	XHEMAL	QEVANI	DOCI
BARDH	GJON	GJERGJI	RAMAZAN	DELIU	AJSHE	HASAN	DOCI		XHEMAL	SAMI	QEVANI	DOCI
PRENUSHE	PRENG	BROZI	ZYDI	DELIU	ARDIAN	KASAM	HASANAJ		XHEMAL	SAMI	QEVANI	DOCI
EDISON	NIKOLL	DEDA	BUKURIE	DELIU	BASHKIM	RESHIT	FEJZO		MIRJAN	FEJZI	KOXHAJ	LEKA
NIKOLL	DED	DEDA	MUHARREM	DELIU	ELEZ	ISUF	QARRI		HAXHI	TOFIK	FISKA	LEKA
ANTON	BARDHOK	PRENGA	FIQIRI	DELIU	MIRBAN	XHAVIT	LIKA		SOKOL	FASLLI	MEMA	SUBASHI
BARDHOK	PRENG	PRENGA	SHABAN	DELIU	SHKELQIM	RESHID	FEJZA		AGIM	KASEM	MERKAJ	SUBASHI
PJETER	DAVID	SELALA	FATBARDAHA	DELIU	SHEPIT	HYSYEN	QOSE		ENTILJANO	GRANT	SPAHIU	SUBASHI
BARDHOK	FRROK	ZEFI	MEHMET	SPAHIU	HAJRI	SEFER	CANI		XHEVAIR	IZET	TABAKU	SUBASHI
LEKE	FRROK	ZEFI	ZEJNEL	SPAHIU	FATIL	JEMIN	MECOLLARI		LAVDOSH	ILMI	ADËRI	SUBASHI
ANTON	ALI	HILA	SHEMSI	SPAHIU	ASTRIT	ENVER	DAPI		NOVRUS	AVDULLA	KËRKUTA	SUBASHI
LIZA	JEMIN	HILA	TIRANË		EDMOND	LIGOR	OGRENI		ILIR	NEHAT	KALLUÇI	SUBASHI
ERJON	FRROK	KOCA	KLODIAN	FIQIRI	ARBRI	RAMIZ	HOXHA		ALGEN	GEZIM	BAZAJ	SUBASHI
FRAN	GJERGJ	LULAJ	JEMINE	SPAHIU	ISMET	RAMIZ	BRIHMANI		PETRIT	ADEM	BAHO	SUBASHI
ERJON	FRROK	KOCA	JEMINE	DEJIA	ILIR	BRHMANI			KUJTIM	NAZIF	ZYLALI	SUBASHI
ERJON	FRROK	KOCA	RAJMONDA	MEZINI	ALFRED	KASEM	BRHAJA		GEZIM	HALIM	QAMO	SUBASHI
ERJON	FRROK	KOCA	HATLJE	SPAHIU (Zeka)	NEFAL	MEHMET	VLLACAJ		KRENAR	MUÇO	KAPEDANI	MAHMUT

Pjesëmarrja në ceremoninë e Erdoganit, konfirmim i marrëdhënieve strategjike me Turqinë

Hashim Thaçi: Këto ditë do marrim lajme të mira për vizat

Presidenti kosovar: Duhet të ndërtojmë paqe me Serbinë

Pjesëmarrja jonë në ceremoninë e inaugurimit të presidentit Erdogan ka qenë konfirmim i relacioneve tona strategjike mes Kosovës dhe Turqisë", tha presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi. Z. Thaçi u shpreh se pjesëmarrja e tij në ceremoninë inaugurimit të Presidentit të Turqisë, Recep Tayyip Erdogan është konfirmim i marrëdhënieve strategjike mes dy vendeve. Thaçi, i cili u gjend në Turqi për ceremoninë e inaugurimit të presidentit Erdogan, vlerësoi për "Anadolu Agency" (AA) marrëdhëniet mes dy vendeve dhe çështjet rajonale. "Vullneti i popullit të Turqisë është shprehur në mënyrë demokratike. Turqia ka zgjedhur rrugën e vet përmes vullnetit të qytetarëve për të ardhmen e tyre. Rrugën e vetëmenduar të drejtë, të zhvillimit dhe progresit. Prandaj, pjesëmarrja jonë në ceremoninë e inaugurimit të presidentit Erdogan ka qenë konfirmim i relacioneve tona strategjike mes Kosovës dhe Turqisë", tha Thaçi në lidhje me zgjedhjet e 24 qershorit të mbajtura në Turqi. Ai shprehu mirënjohje për faktin që Turqia është një ndër vendet e para që ka njohur pavarësinë e Kosovës. "Po pres vazhdimin e bashkëpunimit tonë të mirë, një bashkëpunim ky që do të jetë në të gjitha sferat e jetës institucionale. Turqia ka mbështetur Kosovën edhe më herët. Pres edhe në të ardhmen ta mbështesë fuqishëm, në veçanti në njohje e reja dhe integrimet në organizatat ndërkombëtare", është shprehur Thaçi. "Kosova do të vazhdojë bashkëpunimin me Turqinë në të gjitha sferat". Thaçi më tutje tha se ka hapësirë për të bërë më tepër në marrëdhëniet bilaterale ekonomike, duke shtuar se në kuadër të vizitës së tij në Turqi, ka ftuar investitorët në Kosovë. "Kosova do të marrë lajme të mira për liberalizimin e vizave në ditët e ardhshme. "Takimi fillestar mes presidentëve të Kosovës dhe Serbisë ka ndodhur në Bruksel dhe ka qenë një takim konstruktiv", tha Thaçi, duke njoftuar se në ceremoninë e inaugurimit të presidentit Erdogan kanë pasur mundësi të përshëndetjen dhe të diskutojnë sado pak. "Shpresoj që në të ardhmen e afërt do të ndodhë takimi tjetër dhe unë jam i vendosur që me të vërtetë të ndërtojmë paqe përfundimtare mes Kosovës dhe Serbisë, në interesin e Kosovës, Serbisë, Bashkimit Evropian, por edhe vetë investimeve për stabilitetin në Ballkanin Perëndimor. Unë shpresoj se me rolin udhëheqës të Bashkimit Evropian dhe mbështetjen e plotë të SHBA-ve, por edhe partnerëve të tjerë, kjo marrëveshje e paqes Kosovë-Serbi do të mund të arrihet në të ardhmen e afërt", tha



Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi

Thaçi. Ai u shpreh se gjatë qëndrimit të tij në Ankara ka biseduar me kryeministrin e Rusisë, Dmitri Medvedev. "Diskutuaam për mundësinë e vënies së komunikimit fillestar mes dy shteteve tona, Kosovës dhe Rusisë. Gjithashtu, informo-

va edhe për takimin që kemi zhvilluar në Bruksel me presidentin e Serbisë. Për realizimin e atyre objektivave që i kemi në këtë proces për paqen, stabilitetin në Ballkanin Perëndimor. Është shumë me rëndësi që marrëveshjen eventu-

ale të paqes dhe të pajtimit mes Kosovës dhe Serbisë ta pranojë edhe Rusia. Shpresoj se në ditët e ardhshme do të kemi lajme pozitive, lajme shumë të mira nga Bashkimi Evropian sa i përket liberalizimit të vizave dhe pastaj do të hapet

HASHIM THAÇI
"Kosova do të marrë lajme të mira për liberalizimin e vizave në ditët e ardhshme. Shpresoj që në të ardhmen e afërt do të ndodhë takimi tjetër dhe unë jam i vendosur që me të vërtetë të ndërtojmë paqe përfundimtare mes Kosovës dhe Serbisë, në interesin e Kosovës, Serbisë, Bashkimit Evropian, por edhe vetë investimeve për stabilitetin në Ballkanin Perëndimor", tha Thaçi.

mundësia që edhe institucionet e tjera, Komisioni Evropian, Parlamenti Evropian të konfirmojnë këtë arritje të Kosovës. Kosova ka implementuar në tërësi kriteret për liberalizimin e vizave", tha presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi për 'AA'.

Thaçi: Askush s'e përbyll vetëm dialogun dhe as të pengojë procesin

Caktohet më në fund data, javën e ardhshme mbahet raundi i ri i bisedimeve Kosovë-Serbi



tikës së jashtme të Bashkimit Evropian, Federica Mogherini ka caktuar për të mërkurën, më 18 korrik, raundin e ri të bisedimeve

ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Në një njoftim të zyrës së saj thuhet se në takimin ndërmjet Presidentit të Kosovës, Hashim

Hashim Thaçi

"Shteti është i të gjithëve dhe askush nuk mund ta përbyllë vetëm procesin, gjithashtu askush nuk mund ta blloktoj ose t'i vërë veton këtij procesi. Ky proces i dialogut do të mbyllet me njohjen e jure të Kosovës nga Serbia", ka shtuar Thaçi.

Thaçi dhe atij të Serbisë, Aleksandër Vuçiq do të shqyrtohet përparimi në diskutimet për marrëveshjen gjithëpërfshirëse për normalizimin e marrëdhënieve, si dhe për planet dhe hapat e ardhshëm për t'u siguruar se puna do të vazhdojë me një ritëm të përshpejtuar.

SHKURT

Kaos me dyndjen e emigrantëve në Europë

Berlini, Roma dhe Vjena arritën të bien në një mendje për mënyrën se si do të zgjidhet kaosi i krijuar në Europë nga dyndjet e emigrantëve të jashtëligjshëm. Ministrat e Brendshëm të tri vendeve u takuan në Insbruk të Austrisë, aty ku ranë dakord për pikat kryesore të planit që ata do t'i parashtrijë Bashkimit Evropian. "Do t'i kërkojmë mbështetje të vërtetë Europës për kontrollin e rreptë të kufijve të jashtëm dhe për të shpërndarë peshën e zbakimeve që deri më sot e ka mbajtur vetëm Italia", tha Matteo Salvini, ministër i Brendshëm i Italisë. Liderët këmbëngulin në zgjidhjen me kampe në vendet afrikane, ku të bëhet që në burim përzgjedhja e atyre që meritojnë azilin në vendet europiane. Në këtë pikë, ministrat gjermanë dhe austriakë bashkohen me Salvini, i cili thotë se vetëm kështu do të reduktohet numri i emigrantëve që rrezikojnë jetën, duke lundruar në mënyrë klandestine në Mesdhe. Liderët kërkojnë që në të ardhmen, Brükseli t'i detyrojë me marrëveshje vendet afrikane të ripranojnë emigrantët nga këto vende, të cilët nuk plotësojnë kushtet e azilit në vendet europiane. Ndërsa deri në fund të korrikut, Roma dhe Berlini do të kenë gati marrëveshjen për ripranimin në Itali të emigrantëve të regjistruar si të hyrë atje, por që strehohen në Gjermani.

Turqi, kishin shkur për plazh, helmohen 72 pushues

72 pushues të një hoteli në Alanja të Turqisë janë dërguar në spitalet e zonës pas shqetësimeve të ndryshme që besohet se janë shkaktuar nga helmimi. Agjencia turke e lajmeve "DHA" raporton se disa prej pushuesve të hotelit, emri i të cilit nuk bëhet i ditur, janë dërguar në spital pasdrekën e së mërkurës pasi patën të vjella dhe gjendje të fikëti. Afër mbrëmjes, shqetësime të ngjashme përjetuan edhe ata që kishin mbetur në hotel. Pasi disa femijë nisën të vllinin në korridor, familjarët të alarmuar njoftuan shërbimet shëndetësore. Në dyert e hotelit mbërritën 25 ambulanca. Së bashku me personat e tjerë që shkuan me mjete të tjera në spitalet e zonës, mësohet se numri i personave që u paraqitën për ndihmë mjekësore arriti në 72. "DHA" citon njërin prej pushuesve, Hasan Ates, tek fajëson higjienën në hotel për të gjithë ngjarjen. Alanja, së bashku me Antalian, Kemerin dhe Bodrumin është ndër destinacionet më të preferuara turistike të verës në Turqi.

PIKA E LUMTURISË NË TRUPIN TUAJ: ME NJË LËVIZJE NXIRRENI TËRË ENERGJINË NEGATIVE!

SUMMER

pages

SUPLEMENT I GAZETIA SHQIPTARE

E premte 13 Korrik 2018



ISH-BANORJA E
'BIG BROTHER'

Franceska 'çmend' ndjekësit

Franceska Jaçe
qenka e virgjër



Besi dhe Xhensila
bëhen prindër

BULEVARDI
POLITIK



- Qeveritarët kroatë heqin kostumin zyrtar, si shkuan në mbledhje
- May zhgënjehet nga Anglia, Rama: Kupa e Botës po vjen në Ballkan!
- Samit i vështirë për Juncker, i merren këmbët e s'le lider pa puthur
- Haradinaj: Jam shqiptar, kemi ekzistuar para Muhamedit apo Jezusit



Rrëfehët stilistja: Puna, pasion dhe profesion si binom perfekt

REZARTA SKIFTERI:

Ja cilat do të jenë tendencat e kësaj vere

"Është momenti i duhur për të lobuar jashtë"

Rrëfëhet stilistja: Puna, pasion dhe profesion si binom perfekt

Rezarta Skifteri:

Ja cilat do të jenë tendencat e kësaj vere

"Është momenti i duhur për të lobuar jashtë"

Egla Xhemali

Ajo është një nga stilistet më të njohura dhe më të dashura në Shqipëri. Bëhet fjalë për Rezarta Skifterin. Bukuroshja vjen në një rrëfim ekskluziv për suplementin "Summer Pages" në një dimension tjetër: Rezarta na tregon për aktivitetin që e mbajnë në formë, për dashurinë e madhe që ka për punën e saj, për projektet që ka jashtë kufijve e së fundmi i sugjeron vajzat në lidhje me tendencat e fundit të kësaj vere. Sekretet e linjave perfekte është padyshim aktiviteti sportiv, i cili është kthyer tanimë në një pasion për bukuroshen. Ajo e sheh punën me veshjet si diçka mjaft të shenjtë, që e përfaqëson dhe e prezanton atë. Skifteri është në hapat e duhur për të lobuar edhe përtej kufijve me stilitet e saj. Rezarta jep një sugjerim për tendencat më të fundit të kësaj vere duke përmendur ngjyrat, prerjet, materialet dhe detajet që do u shkojnë përshat ditëve të nxeha të kësaj vere.

Si ka nisur vera për Rezartën?



Vera për Rezartën ka nisur si çdo sezon tjetër me ngarkesën e punës, pasi për mua ngarkesa më e madhe e punës është sezoni i verës, ndryshe ndoshta nga profesionet e tjera.

Në çdo dalje tuajën vihen re linjat perfekte. Si la diloni që jeni gjithmonë në formë?

Faleminderit shumë për komplimentin! Linjat e mia janë perfekte nga dy gjëra. E para, e kam gjenetikisht linjën



e trupit të tillë, por që jashtëzakonisht shumë ndihmon sporti dhe unë merr me fitness. Mendohem t'i kushtoj vëmendje kësaj pjese, pasi jo vetëm bën mirë për organizmin, për trurin, për trupin, por është edhe tepër e shëndetshme e mbi të gjitha duken edhe rezultatet. E nisa pasi e kisha të nevojshme mendërisht që të isha pak më e qetë. Kisha ngarkesë shumë të madhe në punë dhe tani më është kthyer në një pasion të jashtëzakonshëm, që e dua dhe e dashuroj.

Puna me veshjet është sa e bukur, aq edhe e lodhshme. Sa kohë ju rrëmbejnë stilitet?
Puna është sa e bukur aq dhe e lodhshme, kjo është e vërtetë. Natyrisht, nuk mund të jetë vetëm e bukur, ka dhe vështirësitë e saj, por janë vështirësi të bukura, sepse dihet që në fund fare do sjellin një veshje apo një projekt të bukur; pra puna ime ka gjithmonë lidhje me të bukurën, me femi-nilen, me detajet, gurët. Çdo pjesë dhe çdo momenti i punës sime është tepër i bukur; kështu që edhe kjo është dashuria ime e parë dhe që nuk shteron si dashuri, e besoj që gjithë jetën time do jem e pandarë me të. Ka dy kategori

njerëzish, ata që thashë edhe më sipër, vërtetë jam natyrë e ndjeshme, por kur i futem një gjëje nuk më step dhe nuk më trembin absolutisht pengesat që kam përpara, por luftoj për të arritur gjënë që dua.

Kenë menduar ndonjëherë të loboni me veshjet tuaja në tregun ndërkombëtar?
Po, kam menduar të hap një linjë time edhe jashtë Shqipërisë. Është një op-sion që më është dhënë disa herë, por unë i kam thënë jo. Tani ndoshta është momenti i duhur sepse dhe gjërat le të themi duan kohën e vet. Kam më pak se një vit që kam marrë çmimin in "Argjendte", pra që futet tek stilistët e rinj dhe unë në karrierën time të punës quhem te stilistët e rinj, kështu që them se jam në momentin e duhur tani. Gjërat janë pjekur për të hapur diçka dhe jashtë Shqipërisë.

Çfarë e motivon Rezartën?

Çdo gjë e bukur sinqerisht. Unë jam natyrë e ndjeshme, siç thotë ime më dhe im atë je totalisht artiste. Kështu kam qenë gjithmonë që femijë, që e vogël këtë lloj natyre kam pasur: Jam ndjeshme si femër; por shumë e fortë në gjërat që vendos. Pra gjërat që marr përsipër nuk kthehen mbrapsht, ose nuk kam frikë në atë që ndër-marr: Kjo gjë në punën time ndikon shumë pozitivisht, sepse çdo gjë që është e bukur, natyra, dielli, lulet, ajri i pastër; apo edhe njerëzit që më rrethojnë, ata që më duan janë arsyesit që më frymëzojnë për punën time.

Kush ka qenë shtysa që ju futët modës?

Në fakt nuk ka qenë asnjë, ka qenë ëndërr e imja. Shpesh kur e mendoj si e nisa këtë pjesë të karrierës dhe si e mbarova shkollën, pasi studimet që kam përfunduar janë pikërisht për këtë profesion që ushtroj sot dhe të mendosh që nuk kam qenë më shumë se shtatë vjeç kur me laps e letër në dorë pikturoja. Bëja modele, linja të trupit të femrës me fustane dhe rrija gjithë ditën duke bërë këtë gjë, ndërkohë që mund të luaja me kukulla apo të bëja diçka tjetër siç bënin femijët e tjerë. Unë preferoja të pikturoja e të bëja modele fustanesh, domethënë ka qenë një pjesë e brendshme e imja, zë i brendshëm që gjithmonë më ka thënë që është kjo, ajo që ti dëshiron dhe kjo është ajo që ti ke më për zemër të bësh në jetën tënde, kështu që ndiqe ëndërrën tënde. Sinqerisht, unë e kam ndjekur: Nuk ka qenë e lehtë, ka qenë e vështirë, sepse siç ka bërë rryla sot, ka pasur edhe kur unë kam qenë në fillimet e mia. E kam nisur karrierën në ekran që 14 vjeç, kështu që gjithmonë ka pasur bërë rryla, por unë siç

thashë edhe më sipër, vërtetë jam natyrë e ndjeshme, por kur i futem një gjëje nuk më step dhe nuk më trembin absolutisht pengesat që kam përpara, por luftoj për të arritur gjënë që dua.

Kenë menduar ndonjëherë të loboni me veshjet tuaja në tregun ndërkombëtar?

Po, kam menduar të hap një linjë time edhe jashtë Shqipërisë. Është një op-sion që më është dhënë disa herë, por unë i kam thënë jo. Tani ndoshta është momenti i duhur sepse dhe gjërat le të themi duan kohën e vet. Kam më pak se një vit që kam marrë çmimin in "Argjendte", pra që futet tek stilistët e rinj dhe unë në karrierën time të punës quhem te stilistët e rinj, kështu që them se jam në momentin e duhur tani. Gjërat janë pjekur për të hapur diçka dhe jashtë Shqipërisë.

Çfarë sugjerim do u jepni vajzave për tendencat e kësaj vere?

Janë disa, sa u përket kolo-reve do shohim ngjyrat pastel siç është roza e lehtë, siç është ngjyra e lejlajës apo e vio-

zotërojnë në këtë sezon. Sa u përket prerjeve do shohim shpeshherë truporet në formë palicetë me materiale të lehta, dizeno me këto ngjyra që unë përmenda dhe që janë relativisht të shkurtra, të lehta që valëviten në trup dhe duke qenë që është në stilin palicetë është shumë komode dhe praktike, pasi nuk bëjmë shumë kombinime. Mbarojmë punën shpejt e duke mi shumë bukur. Një tjetër element janë sërish pantallonat palicetë, xhins këtë herë, që vijnë në formën më sport, më shik. Nëse veshim një takë të lartë dhe mbajmë një T-shirt të bardhë me dizeno apo një kanotierë dukemi bukur. Sa i përket pjesës së plazhit janë rrobëbanjot këtë sezon, që do të jenë qoftë trupore, qoftë veç e veç, ku nuk mungojnë prej 6-7 vitesh rrobëbanjot me shtat të lartë pasi këto japin një bel jashtëzakonisht të bukur. Sa i përket materialit të tyre do të shohim shpeshherë materialin e kadifes zero, që është futur së fundmi. Është hera e parë që përdoret ky material te rrobëban-

jo. Këto të fundit do të jenë me lidhje në formë gonxheje poshtë gjoksit apo dhe anash tek ijët. Rrobëbanjot do ishohim me lidhëse të shpeshta dhe një tjetër dizeno që do të përdoret qoftë në fustane, qoftë në këto truporet që unë përmenda. Është edhe dizeno e qershisë, që është futur mjaft fuqishëm e në fakt është një frut që është jo vetëm i ëmbël, po dhe i bukur kështu që është përdorur qershia në këto dizeno që është stilistët kanë realizuar këtë sezon .pasi jepen lloj ëmbëlsie, freskie sensualiteti femrës. Qershinë nuk do e shohim vetëm tek femrat, por edhe lehtështëm esigur-




letës dhe nuancat e saj, gjithmonë janë të sfumua, të lehta janë shumë flu si kolo-re. Është ngjyra e jeshiles së lehtë, e jeshiles ushtarake, ngjyra e verdhë, tjetër ngjyrë është e kuaja bordo, e bardha, vetëm se nuk është e bardha e pastër siç ndodh në çdo sezon, por është një e bardhë qumësht, kremoz. Këto janë pak a shumë kolo-ret që mbi-

ishtë gjithmonë të minimizuar dhe tek veshjet e meshkujeve. Materialat që do përdoren janë mëndafshi që është i lehtë, i rehatshëm dhe shumë i freskët për sezonin e verës. Është materiali i napës, ilinos, sateni gjithmonë materiali të lehta të cilat jo vetëm ndihmojnë të dukesh bukur; por të jesh dhe komode në këto ditë vere të nxeha.


Besi dhe Xhensila bëhen prindër, këngëtarja emocionon me fjalët

Ditën e djeshme, këngëtarja e njohur Xhensila Myrtezaj dhe aktori i humorit Besart Kallaku bëhen për herë të parë prindër. U mësuua se bukuroshja solli në jetë vogëlushen në një spital privat dhe nënë e bije gëzojnë shëndet të plotë. Burime për 'Iconstyle' kanë zbuluar emrin e veçantë që Xhensila dhe Besi kanë vendosur për të voglën e tyre. Çifti e ka pagëzuar atë me emrin Ajka, që në gjuhën shqipe bart kuptimin e pjesës më të mirë të diçkaje. Artistët duken tejet të emocionuar. Këtë gëzim të madh e kanë ndarë dhe me fansat e tyre nëpërmjet postimeve në rrjetin social "Instagram". "Të mbaj në krahë, e ta ndjej frymën, edhe aromën, a thua se të gjitha lulet e kësaj toke janë mbledhur grusht tek gusha jote. Cfarë ndjesie qenka të mbash krejt botën në duar. O kënga ime, o poezia ime! Bëj të mirën edhe duaje veten. Për çdo të mirë që do bësh, Zoti do shkurttojë distancën mes teje edhe atij"- shkruan Xhensila. Këngëtarja e mbyll postimin duke i falënderuar të gjithë ata që janë bërë pjesë e lumturisë së tyre.




Tërboi djemtë me fotot e nxehta, Françeska Jaçe qenka e virgjër

Francheska Jaçe është një nga personazhet e showbizit shqiptar që gjithmonë merr vëmendjen e mediave me foto e nxehta që publikon në profilin e saj në "Instagram", ku ekspozon format trupore. Ajo u bë shumë e njohur që pas pjesëmarrjes së saj në "Big Brother" dhe që prej atëherë ka qenë shumë aktive në botën e modelingut. Bukuroshja muajt e fundit është komentuar në media për shkak të lidhjes me biznesmenin shqiptar, Andi Geci, megjithatë asnjëherë nuk ka pranuar asgjë publikisht. Së fundmi, Françeska u është përgjigjur disa pyetjeve në rrjetin social "Instagram", ku fansat e kanë pyetur nëse është e virgjër. Modelja ka habitur me përgjigjen e saj, teksa ka pohuar se është ende e virgjër.



Luana shijon perëndimin më provokuese se kurrë

Moderatorja seksi Luana Vjollca është duke vijuar pushimet e saj e, gjithashtu, duke publikuar në rrjete sociale foto mjaft provokuese për ndjekësit. Këtë herë e shohim të veshur tërësisht me të verdha duke pozuar sipër jahtit, ndërkohë që është duke shijuar perëndimin e diellit. Sipër fotos bukuroshja ka lënë mbishkrimin "Ndjenjë". Edhe këtë herë fotot e saj nuk kanë ngelur pa u komentuar nga fansat.



Nuk përmbahet Anxhelina, tregon tatuazhin mes gjoksit

Anxhelina Hadërgjonaj është një nga këngëtares me seksi në tregun muzikor. Bukuroshja arrin të tërheq gjithmonë vëmendjen e mediave. Anxhelina është shumë aktive në rrjetet sociale dhe shpesh herë publikon foto shumë provokuese. Së fundmi, Hadërgjonaj ka treguar përpara gjithë fansave një tatuazh që ka në trupin e saj, që askush nuk e kishte venë re më parë. Ajo ka publikuar një foto ku shfaq pjesën e gjoksit, ku ka një tatuazh me tri shtata. Siç duket shtata është numri me fat për Anxhelinën, aq sa ajo e ka gdhendur dhe në trupin e saj.





Në trupin tonë ekziston organi për të cilin shumë pak dihet, mirëpo me të drejtë mund ta quajmë pikë lumturie!

Ajo që nga e tëra është më e mira, nuk është e nevojshme të kërkohet gjatë - ai është, timusi, me dy lobe e zhytur në një masë indi lidhor në brendësi të zgavrës së kraharorit, zakonisht menjëherë pas dërrasës së kraharorit dhe përpara aortës.

Timusi prodhon disa hormone, por vetëm njërit i është njohur funksioni - timozinës, i cili luan rol në zhvillimin dhe ruajtjen e mbrojtjes imunologjike normale.

Si ta aktivizojmë pikën e lumturisë

Goditja e lehtë, përkëdhelja dhe masazhi i kësaj pike janë metoda shumë efikase, të cilat ndihmojnë në ngritjen në një nivel më të lartë të vibracionit tuaj energjik.

Kjo gjëndër mban energjinë e trupit tonë, prandaj kur në sistemin tonë energjik ndodh disbalanca, mu kjo gjëndër mund të ndihmojë. Ajo është urë midis trurit dhe trupit. Nën ndikimin e stresit gjëndra zvogëlohet, gjë që çon në zvogëlimin e energjisë jetësore.


Gjendrën e kraharorit mund ta stimuloni edhe me grusht, vetëm që duhet goditur lehtë, jo të goditet fortë gjoksi. Mund të goditni apo të bëni masazh me gishta. Bëjeni këtë përafërsisht 20-30 sekonda dhe merrni thellë frymë.

Natyrisht, mund të thoni edhe ndonjë afirmacion pozitiv në atë moment. Do të mësoni kur të aktivizohet pika juaj e lumturisë - do të ndieni se si do t'ju kalojnë rrëqethje nëpër trup dhe do të keni ndjenjën e gezimit dhe të lumturisë.

Mund të kalojë një kohë e caktuar derisa të ndieni diçka, mirëpo bëjeni këtë ushtrim çdo ditë dhe me siguri do të përjetoni efikasitetin e tij.

Pika e lumturisë në trupin tuaj: Me një lëvizje nxirreni tërë energjinë negative!

Nëse keni shpesh sulme paniku, anksoziteti dhe stresi, bëni kështu disa herë në ditë dhe do të keni mundësi të ktheni balancën tuaj jetësore.



Thymus gland

Qeveritarët kroatë heqin kostumin zyrtar, si shkuan në mbledhje

Kroacia arriti të shkojë në finale të Botërorit për herë të parë në histori, pasi mposhti Anglinë me rezultatin 2-1. Një arritje që ka sjellë festë në popullin kroat, ndërkohë që ajo që ka ndodhur në një mbledhje të kabinetit qeveritar kroat është mjaft interesante. Në mbledhjen qeveritare shumë nga anëtarët kanë marrë pjesë të veshur me fanellën e kombëtares kroate. Kualifikimi në finale ka entuziazmuar kroatët dhe presidenten e tyre, Kolinda Grabar-Kitarović. Ajo menjëherë pas përfundimit të ndeshjes shprehu emocionet e saj në "Facebook", duke shkruar: "Populli im, është e mundur! Bravo të zjarrtit! Bravo të gjithë tifozëve! Kroacia në finale!". Kroacia do të përballet në finale me Francën.



May zhgënjehet nga Anglia, Rama: Kupa e Botës po vjen në Ballkan!

Kryeministri Edi Rama ka ndjekur minutat e fundit të ndeshjes

Angli-Kroaci së bashku me disa prej liderëve të pranishëm në samitin e NATO-s. Pasi ndeshja përfundoi me humbjen e anglezëve 2-1, kreu i qeverisë shqiptare iu drejtua kryeministres britanike duke i thënë: "Kupa e Botës po vjen në Ballkanin Perëndimor". Duke ndjekur ndeshjen nga një aparat celular ishte edhe kancelarja Angela Merkel dhe Presidenti i Turqisë, Reçep Tayyip Erdogan.



BULEVARDI

Në merrni seriozisht! 😊

POLITIK



Samiti i vështirë për Juncker, i merren këmbët e s'le lider pa puthur

Nëse mendoni se samiti i NATO-s mund të ketë qenë i vështirë për disa udhëheqës për çështjet e pagesave për aleancën, gaboheni. Ky takim, më i vështirë se për këdo, ka qenë për presidentin e Komisionit Evropian, Jean Claude Juncker. Juncker ka qenë i pranishëm në një nga mbrëmjet gala të këtij samiti, ku është filmuar në një gjendje jo fort të mirë shëndetësore. Presidenti i KE-së është penguar disa here, ka humbur ekuilibrin e trupit dhe është parë i dashur me shumë nga udhëheqësit e BE-së. Shoqërimin në këtë pritje ia ka dhënë kryeministrit maqedonas, Zoran Zaev, i cili e ka mbajtur për krahu gjatë gjithë kohës Juncker-in. Ky i fundit s'ka harruar të takojë e të uthë presidentin francez Emmanuel Macron, kancelaren gjermane Angela Merkel dhe sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s, Jens Stoltenber.



Haradinaj: Jam shqiptar, kemi ekzistuar para Muhamedit apo Jezusit

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, deklaroi se identiteti kombëtar është identiteti i parë i tij. "Unë jam shqiptar, nuk jam mysliman, feja nuk është identiteti im i parë", ka thënë ai për gazetën "Middleeasteye". Haradinaj ka thënë se kosovarët jetojnë një "botë tjetër" prej asaj të myslimanëve të Lindjes së Mesme. "Ne jemi një komb euroatlantik. Kur ne ishim në telashe, SHBA dhe NATO ishin me ne, kështu që ne i përkasim këtij grupi", theksoi ai. "E vërteta është se ne kemi ekzistuar për më shumë se 2000 vjet para Muhamedit apo Jezusit. Kemi jetuar si të krishterë për shumë kohë dhe pastaj e kemi pranuar fenë myslimane, nëpërmjet administratës osmane", ka shtuar Haradinaj.



LIBRI

ODIL DANIEL

Një franceze në Tiranë më 1978, dashuria e pamundur e Maks Velos

Fatmira Nikolli

"Maks Velo, jeta paralele", Alda Bardhyli sjell në një libër dosjen e sigurimit të Maks Velos

"Odila më ka dërguar me postë 'Pikason', 'Martin Ferrier', i kam dhuruar 3-4 piktura"

Dosja sekrete e Sigurimit të Shtetit për Maks Velon do të vijë shumë shpejt në një libër nga UETPRESS. "Maks Velo, jeta paralele", titullohet libri i përgatitur nga Alda Bardhyli, i cili për herë të parë zbardh dosjen e plotë të artistit duke nisur nga përndjekja, hetuesia dhe burgu. Janë më shumë se 100 dokumente raportimesh mes të cilëve dhe personazheve të njohur në jetën artistike shqiptare, përmes së cilave ne shohim jetën tjetër të Velos. Ajo çfarë e bën të veçantë këtë libër është fakti se Bardhyli sjell anën tjetër të rrëfimit të asaj çfarë është raportuar në dosje. Kështu lexuesi ka mundësi të shohë dy histori të së njëjtës ngjarjeje, atë të treguar nga Sigurimi i Shtetit dhe atë të treguar nga vetë Velo.

"Botimi i dosjes së plotë të Maks Velos shoqëruar me rrëfimin e tij për raportime të ndryshme kërkon jo vetëm të tregojë historinë e jashtëzakonshme të një artisti tepër bashkëkohor në kushtet e një diktature të ashpër, antikonformist dhe me vizione liberale për artin, vizione të cilat i kushtuan vite burg, por dhe të hapë një debat të munguar rreth artit dhe kulturës gjatë soc-realizmit", thotë Bardhyli. Rasti Velo, sipas saj është një rast i qëndrësës që arti mund ta bëjë përballë regjimeve totalitare. "Nëse lexon gjithë dosjen e përndjekjes, raportimet, shikon një rritje të figurës së Velos si një ëndërrimtar dhe një profil kulturor superior, përballë kulturës së kohës", thotë Bardhyli.

Edhe pse kemi të bëjmë me botimin e një dosjeje të plotë, Bardhyli thotë se ky libër i ngjan një romani thriller.

"E gjithë skema e përndjekjes së Velos i ngjan një romani thriller. Në pjesën më të madhe raportuesit janë miq të artistit deri tek njerëzit e afërt të shtëpisë. Kam pasur hezitime se si duhet ta botoja dosjen, por në fund vendosa t'i lë ash-



Në foto: Alda Bardhyli, autore e librit

“Botimi i dosjes së plotë të Maks Velos shoqëruar me rrëfimin e tij për raportime të ndryshme kërkon jo vetëm të tregojë historinë e jashtëzakonshme të një artisti tepër bashkëkohor në kushtet e një diktature të ashpër, antikonformist dhe me vizione liberale për artin”

tu siç janë, pasi janë raporte ku ngjarja tregohet me kureshtje. Kjo pasi raportuesit nuk ishin punonjës të zakonshëm të Sigurimit, por artistë", thotë ajo. Sigurisht që ky libër do të prekë shumë emra njerëzish që përmenden në dosje, por që UET PRESS dhe Velo kanë vendosur t'i lënë me emrat realë duke mos fshehur asgjë. Sipas saj, artet sh-

qiptare me Velon kanë përfaqësimit e tyre më dinjitoz në komunizëm, si një figurë e cila nuk u dorëzua as në kushtet e një presioni në hetuesi, ashtu siç ndodhi me shumë artistë të tjerë që përmenden në libër.

PJESË NGA LIBRI

D Ë S H M I T A R I HETUESI

/Genc Hajdari/ /Dhimitraq Shkodrani/

PROCESVERBAL /DËSHMI/

Në Tiranë, më 8/XII/1978

Unë hetuesi Dhimitraq Shkodrani mora në pyetje me cilësinë e dëshmitarit qytetarin Miltjadh Jorgji, i biri i Jorgjit dhe i Theodorës, i datëlindjes 1938, lindur në Leskovik dhe banues në Tiranë në lagjen 8, Rr. 'Lidhja e Prizrenit', P.6, Sh.1, Ap.4, pa parti, i padënuar, i martuar, me arsim të mesëm, me punë piktor pranë R.Televizionit, me kombësi dhe nënshpëtimshqiptare.

Dëshmitari u paralajmërua për përgjegjësinë penale në bazë të nenit 202 të K.P për dëshmi të rreme. **DËSHMITARI /Miltjadh Jorgji/** Dëshmitari u pyet rreth çështjes dhe deklaroi: Unë me Maks Velon njihem që nga viti 1966-'67, por me të ndonjë shoqëri nuk

kam pasur. Me të nga afër jam njohur në dasmën e inxhinierit Luan Pipës, ku që të dy i kemi shkruar Luanit për t'i uruar martesën. Në dasmë Maksi kishte sjelle si peshqesh një portret të një malësoreje. Në lidhje me këtë u hap biseda. Portreti ishte pak i deformuar, me tendencë moderniste, sidomos qafa e saj e gjatë. Maksi na tha se një punë të tillë ia kam dhuruar një mikeshës sime franceze që kishte ardhur në Shqipëri. Ajo e ka marrë me vete dhe e kishte vënë në laboratorin e saj. Pas ca kohësh kjo francezeja ka ardhur përsëri në Shqipëri dhe më ka

kësaj unë kam ikur. Për tablonë nuk di gjë se çfarë u bë.

Me rastin e 30-vjetorit të themelimit të partisë u hap një ekspozitë e arteve figurative, ku ndërmjet të tjerave kishte tablo me ndikime të huaja siç ishte "Epika e yjeve të mëngjesit", e Edison Gjergos dhe ajo e Edi Hilës "Mbjellja e pemëve". Kur u bë diskutimi krijues në sallën e vjetër të ekspozitës, midis të tjerëve ka folur edhe Maksi. Ai ka mburrur punën e Edisonit duke e quajtur një tablo progresive dhe ka kritikuar tablonë "Demaskimi i Ballit

Kombëtar" të piktorëve vlonjatë Skënder Milori, Nestor Jonuzi dhe Himi Bani. Në tablo ishte figura e udhëheqësit kryesor të Partisë i cili demaskonte krerët e Ballit. Pikërisht për këtë tablo Maksi është shprehur me këto fjalë se: "Ne përpara kësaj tabloje kalojmë indiferentë dhe ndalem te tabloja e vogël e Abdurrahim Buzës "Shqipëria në feste". Këtu Maksi e kishte fjalën

thënë mua që në kohën e revolucionit të studentëve në Francë kanë ardhur studentët në laboratorin tim e kanë shkatërruar çdo gjë, me përjashtim të portretit tënd.

Në një rast tjetër kur ka qenë një ekspozitë të ushtrisë e piktorët ishin mobilizuar për të punuar për ekspozitën. Edison Gjergo po bënte një tablo me temë zbori ku flitej për tri vajza zboriste të cilat kishin në sfond monumentin e Skënderbeut dhe një qiell të errët, shumë pesimist. Për këtë tablo Maksi fliste me simpati dhe e përkrahte Edisonin që ta përfundonte. Unë aty kam ndërhyrë dhe i kam thënë si Maksit ashtu dhe Edisonit se kjo tablo nuk ka vërtetësi, nuk i përgjigjet realitetit. Maksi m'u përgjigj me përbuzje: "Unë nuk po flas me ty". Pas

se tabloja e piktorëve vlonjatë nuk kishte vlera artistike.

Po në këtë mbledhje, duke folur për estetikën, Maksi ka patur në dorë një ftesë ku ishte në kopertinë kazma dhe pushka. Maksi për këtë ka thënë se kjo është një ftesë banale. Nuk ka përse të vëmë kazmën dhe pushkën në ftesë, por diçka tjetër më estetike. Në këtë mënyrë mundet që të edukojmë njerëzit me ndjenjën e të bukurës.

Procesverbali m'u lexua, thëni dhe mia ishin shkruar drejt, të cilat i vërtetoj me firmën time.

I PANDEHURI HETUESI /Maks Velo/ /Dhimitraq Shkodrani/

PROCESVERBAL



/Mbi pyetjen e të pandehurit/

Në Tiranë, më 14/XI/1978

Unë hetuesi Dhimitraq Shkodrani mora në pyetje të pandehurin Maks Velo, i cili pohoi:

Pyetje: Na tregoni i pandehur nëse jeni njohur me ndonjë grua franceze, më rast se po në çfarë rrethanash jeni njohur?

Përgjigje: Unë me albanologun Odil Danjele jam njohur në vjeshtën e vitit 1964. Në atë kohë shkoja studioja në Bibliotekën Kombëtare te godina e vjetër në Rrugën e Elbasanit. Aty në Sallën Shkenore vinte edhe Odila. Një pasdite e kam ndihmuar atë të sporteli i librave duke i përkthyer bibliotekares se çfarë kërkonte ajo. Më vonë kemi biseduar në pushimin e leximit. Ajo më tha se kishte studiuar në shkollat e gjuhëve orientale për shqipen. Në atë kohë kishte ardhur për t'u specializuar për gjuhën shqipe. E kam shoqëruar atë disa herë në hotel "Dajti" ku ajo banonte. Pasi dilnim nga biblioteka, kemi shëtitur dhe kemi shkruar në pasticeri. Ajo ishte një vajzë shumë studioze, e urtë dhe e thjeshtë. Mua më la përshkrim shumë të mira dhe për këtë e kam çuar një ditë për vizitë në shtëpi, e kam njohur me nënën time. Odila më ka treguar për familjen e saj. I ati i kishte vdekur menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore, pasi ishte sëmure në kampet gjermane. Kishte gjyshen, nënën dhe dy motra të tjera. Më ka thënë se jemi rritur me vështirësi, vetëm me pensionin e vogël të babait. Të dyja



Në foto: Maks Velo

“
Kur Odila ka ikur për herën e dytë, jam thirrur nga organet kompetente dhe më kanë thënë që të mos shoqërohesh me të. Pastaj me të e kam rralluar korrespondencën derisa e kam prerë fare.

motrat i kishte të martuara. Këtu ka ndënjur 4-5 muaj e pasi ka mbaruar specializimin në fillim të vitit 1965, ajo ka shkuar në Francë. Unë asaj i kam dërguar libra dhe revista shkencore si studimet historike, studime gjuhësore, libra mbi gjuhësinë, revistën "Shqipëria e Re", albumin "Shqipëria marshon" etj.
Në verën e vitit 1969 ose 1970 Odila ka ardhur për herë të dytë. Ajo ka ardhur përsëri për vizitë në shtëpinë time. Në hotel "Dajti" ka qëndruar rreth dy muaj, e ftuar nga Instituti i Gjuhësisë. Ajo më ka thënë se kishte ardhur për të grumbulluar materiale në bibliotekë për dizertacionin shkencor që ishte duke punuar për të marrë gradë shkencore. Më ka thënë se ajo ishte shumë e kënaqur që vinte në Shqipëri. Tirana ka bërë kaq ndryshime, biblioteka e re në Pallatin e Kulturës është

të shumë komode, e ndiej veten shumë të kënaqur sa herë që vij në Shqipëri. Me mua sille shumë mirë. Pasi ka mbaruar periudhën e caktuar, është larguar.

Kur Odila ka ikur për herën e dytë, jam thirrur nga organet kompetente dhe më kanë thënë që të mos shoqërohesh me të. Pastaj me të e kam rralluar korrespondencën derisa e kam prerë fare.

Në dhjetorin e vitit 1977 Odila ka ardhur përsëri në Shqipëri e ftuar nga Instituti i Historisë. Ajo ka ardhur për vizitë në shtëpinë time, ne e kemi pritur dhe e kemi qerasur. Dua të shtoj se Odila më ka dërguar me postë "Pikason", "Martin Ferier" e disa libra të tjerë të vegjël arti.

Dua të shtoj se unë asaj i kam dhuruar 3-4 piktura (vizatime). Gjatë kohës që ajo ka qenë në Shqipëri më ka propozuar për t'u martuar me mua, duke më thënë që të rrijë këtu të punojë në Institutin e Studimeve Gjuhësore. I thashë se në rast se të lejojnë, unë jam dakord që të martohemi. Ajo ishte interesuar në organet kompetente për këtë punë, por unë jam thirrur dhe më kanë thënë që ti të heqësh dorë nga ajo dhe unë kam rënë dakord me ta.

Procesverballi m'u lexua, thënëti e mia ishin shkruar drejt të cilat i vërtetoj me firmën time.

I PANDEHURI HETUESI
/Maks Velo/ /Dhimitaq Shkodrani/

PROCESVERBAL

/Mbi pyetjen e të pandehurit/

Në Tiranë, më 20/XI/1978

Unë hetuesi Dhimitraq Shkodrani mora në pyetje të pandehurin Maks Velo, i cili pohoi:

Pyetje: Na tregoni i pandehur nëse keni dhënë leksion në Institutin e Arteve, në rast se po çfarë lënde keni dhënë?

Përgjigje: Unë në Institutin e Arteve kam dhënë leksion perspektivën që nga viti 1970 deri 1973. Për bazë ishte një libër "Perspektiva për Institutin e Lartë të Arteve". Atë tekst e jepja leksion. Përveç tekstit, gjatë kohës që unë jepja leksion e kam zgjeruar mësimin duke iu folur studentëve edhe për autorë modernë si p.sh. Pikason, Vangogun, Gogen etj. Gjatë shpjegimit të mësimi studentëve iu kam dhënë edhe citate nga këta autorë modernistë, se si mendonin këta piktorë modernist, format, volumet, perspektivën e tyre, raportet dritë-hije dhe të proporcioneve të trupave. Këto mendime të tyre ishin në kundërshtim me ligjet e perspektivës së artit realist. Citate të tyre i kisha nxjerrë nga leximet e librave mbi autorët dhe rrymat moderne.

Procesverballi m'u lexua, thënëti e mia ishin shkruar drejt të cilat i vërtetoj me firmën time.

I PANDEHURI HETUESI
/Maks Velo/ /Dhimitaq Shkodrani/

MARSHIMI PËR TEATRIN ZGJON QYTETARËT

Poshtë diktatura", "Tërhiq", "Mos e dekreto ligjin". Me pankarta "Mburo Teatrin", "Pa Teatër, pa MSA, s'ka Evropë" dhe "ISIS përgjegjëse për 28 monumente kulturore". Kanë qenë këto thirrjet e qytetarëve dje teksa marshuan për teatrin. Në orën 18:30 ata u mbledhën në sheshin mes Teatrit Kombëtar dhe atij Kombëtar Ekspierimental "Kujtim Spahivogli".

Prej aty, nën vëzhgimin e forcave policore marshuan paqësisht drejt bulevardit, për të ndaluar para kryeministritsë e më tej para presidencës ku i bënë thirrje Presidentit të Republikës Ilir Meta të mos dekretojë ligjin që i miratuar nga parlamenti me votat e mazhorancës i hap rrugë shembjes së dy teatrove kombëtarë dhe ndërtimit të një të tilli përmes partneritetit publik-privat.

Artistë dhe intelektualë kundërshtojnë prej muajit shkurt nismën e qeverisë ndërsa kjo e fundit gjatë qershorit e korrikut ka treguar një farë ngutji për të kaluar ligjin megjithëse juristët kanë gjetur shkelje ligjore dhe kushtetuese mes ligjit të sapomiruar dhe MSA-së, ligjeve të mëparshme dhe vetë Kushtetutës. Aktori Neritjan Liçaj i ka përcjellë dhe një mesazh kryeministrit Edi Rama. "Zoti presor vizatimi tërhiq! Turp! Jo me artin... jo me kulturën... jo me vlerat e trashëgimisë të kombit tënde. S'ta lejoj!", është shprehur Liçaj.



Këtë të enjte, qenë qytetarët që mbushën bulevardin me pankarta nëpër duar. Artistë, shkrimtarë, intelektualë, qytetarë të thjeshtë dhe deputetë të futur në radhët e protestuesve për më shumë se një orë e kundërshtuan sërish shembjen e teatrit, formulën PPP, shndërrimin e zonës historike të Tiranës, shndërrimin e pedonale e zonës përreth. Aktivistë të shoqërisë civile ndërkaq folën për pastrim parash, për korrupsion e jo vetëm. Më shumë se s'fjalimet në vetve, protesta vlejti që qëndresën e vazhdueshme, me gjithë propagandën e pafundme që është përpjekur të implikojë përmes akuzave personazhet kryesorë të protestës, çka në çdo kohë tjetër, do të ishte lexuar drejt-por- në kohë proteste lexohet veçse si sulm ndaj atyre që po e mbajnë në këmbë. Të vendosur për ta mbrojtur me çdo kusht, edhe pas rrudhjes së radhëve të artistëve që tanimë janë zëvendësuar nga qytetarët, një protestë qytetare e paqësore i jep shoqërisë imazhin e një shoqërie që ngrihet për kujtesën e vet, teatrit e vet, zërin e vet, pronën publike dhe ligjeve të miratuara nën hije protestash. Marshimi u mbyll para Presidencës.

KUMBARO: OFERTA TURISTIKE 2018, ME ITINERARE TË REJA TË TRASHËGIMISË

Programi i Ministrisë së Kulturës 'Rrugët e Besimit' sjell këtë verë 8 destinacione të reja turistike të objekteve të kultit, me histori dhe vlera të veçanta, ndërsa janë hapur 10 kantieri të reja restaurimi në trashëgimi, jo vetëm për t'i shpëtuar si trashëgimi kulturore, por edhe për t'i kthyer në itinerare turistike. Detyra jonë është të krijojmë itinerare dhe të bëjmë të vizitueshme", - shprehet ministria Kumbaro në këtë sezon të verës 2018. Ministria e Kulturës gjendet e gatshme për të pritur mysafirët e verës. Për periudhën janar-qershor 2018 numri i vizitorëve në muze, kala, parqe arkeologjike është shënuar me 378, 571 vizitorë, në një rritje prej 41% në krahasim me të njëjtin periudhë të vitit të kaluar. Itineraret e reja turistike të objekteve të kultit që i shtohen ofertës turistike 2018 janë: Kisha "Fjetja e Shën Mërisë", Labovë e Kryqit; Kisha e Kosinës, Kosinë, Përmet; Kisha e Sopikut, Pogon; Kisha e Shën Kollit, Voskopojë; Kisha e Shën Mërisë, Voskopojë; Kisha e Shën Ilias, Voskopojë; Manastiri i Shën Prodhomit, Voskopojë; Kisha e Shën Spiridhonit, Vuno, Himarë; Kisha "Shën Thanasi" Karavasta, Lushnjë. Gjithashtu është në proces zbatimi "Rikualifikimi Urban dhe Restaurimi i objekteve në Qendrën Historike dhe Zonën e Mbrojtur në fshatrat Dhërmi dhe Vuno, përkatësisht: 252 objekte në fshatin Dhërmi dhe 182 objekte në Vuno. "Programi i nisur pesë vjet më parë po i jep frytë e veta. Sitet e trashëgimisë nuk janë natyra të qeta, synimi ka qenë të ruhen, të mirëmbahen, por edhe të shfrytëzohen për t'u kthyer në site të jetuara artistikisht. Kemi një boom turistësh, ende në mes të sezonit turistik", - thotë ministria Kumbaro. Kalendarit turistik veror 2018, hartuar nga Ministria e Kulturës në bashkëpunim me institucionet artistike në vend, TKOBAKKVP, Teatri i Kukullave, Cirkul Kombëtar, AQSHF dhe skenën e pavarur; bën bashkë trashëgiminë dhe kulturën, me gjithëpërfshirje nga jugu në veri, duke i kthyer skenat e hapura të trashëgimisë dhe sheshet e qyteteve në skena artistike, në një komunikim të gjallë me publikun. Kalendarit përfshin rreth 70 shfaqje në zonat bregdetare nga Velipoja në Dhërmi, nga Shëngjini në Korçë, nga Shkodra në Ksamil. Festivali e javës që vjen janë: Festivali MULTIKULTUROR, Berat 19-21 korrik; AKKVP me premierën "Sokaku i të Marrëve" Gjirokastrë; 18-21 korrik; ZA? FEST Theth, 20-22 korrik; KORÇA International Short Film Festival, 17-21 korrik; MIK Festival, Korçë, 25-29 korrik dhe Vera Kulturore Maqedonase, Liqenas, 25-30 korrik.



Opinion i Ditës

Rama, kroatët dhe provincializmi ynë kombëtar

Nga Dritan Hila

(vijon nga faqja 1)

...Makronit, i cili duket sikur nuk e ka mëndjen ndaj qasjes së Ramës.

Personalisht videoja më ngjan një montazh i bërë keq. Gjithsesi, edhe nëse është e vërtetë, në ato pak sekonda, po aty shikohet Gjukanoviç që ecën i vetmuar, apo Tsipras që takon gjithë ngrohësi Erdoganin (kjo në vëmendje të puritanëve "filoperëndimorë" shqiptarë).

Shqipëria është një vend i vogël dhe nuk është çudi që as mos ta njohin kryeministrin e saj. Por opozita tregon frustrimin e saj si pjesë të atij kombëtar, dhe kënaqet që kryeministrin të saj nuk ia var njeri. A thua se Berisha dhe Basha janë mjalti ku mblihen gjithë mizat e takimeve ndërkombëtare. Por as Rama vetëm nuk i shmanget këtij provincializmi. Në një foto ka publikuar një bisedë treshe mes Trump-Pompeo dhe Rama. Tani, se çfarë mund të thotë Rama në një takim mes dy demave të politikës së lartë, se për çfarë mund ta kenë pyetur, madje se për çfarë iu duhet Rama atyre, këtë e



dinë vetëm ata që kanë publikuar këto foto. Gjithsesi jo keq për Ramën që ka arritur të marrë një foto qoftë edhe si figurant, ndërkohë që rivali i tij në SHBA po rropatet për një të tillë.

Dhe pastaj situata bëhet më vajtuose në ndeshjen e djeshme mes Anglisë dhe Kroacisë.

Është e kotë të argumentosh se ndeshjet mes kombëtareve janë sa sportive aq edhe politike.

Jo rrallë sporti ka shërbyer si mesazhier paqeje apo ndezës lufte, duke filluar me diplomacinë e pingpongut. I tillë është edhe kampionati botëror. Dhe në ndeshjen e djeshme nuk munguan këto nu-

anca, sidomos për krahun kroat. Është një rezultat i çmuar për një komb, i cili është i vogël në numër dhe nuk ka as 3 dekada pavarësi, por ia ka dalë të afirmohet në shumë fusha. Është i kuptueshëm edhe animi i disa specialistëve të futbollit nga ekipi i vogël për risitë që ka sjellë dhe individualitetet që ka. Por pastaj shfrenimi i shumë shqiptarëve për të bërë tifo për disa njerëz që i konsiderojnë kushërinj të largët meqenëse janë të dy palët pasardhës të ilirëve (!); sepse janë armiq të serbëve; sepse po i tregojnë vendin fuqive të mëdha (mision që as kroatët vetëm nuk e çojnë nëpër mend pasi janë produkt i këtyre fuqive), duhet vetëm një fantazi e çakërditur kombëtare bipolare që herë bën tifo për Ankaranë, herë për Athinë, për Uashingtonin, dhe tani kanë gjetur një Mekë të re ku të falen, ndërkohë që Tiranën e tyre po e bëjnë pocaqi.

Ky është një problem i madh i yni të cilin duhet ta zgjidhim. Ka të bëjë me vetëbesimin dhe respektin për veten. Përndryshe do mbetemi gjithmonë një provincë qesharake e Europës me banorët e së cilës do fillojnë të tregohen barcaleta.

Opinion i Ditës

Nga Monika Kryemadhi

Për 3 muaj e pastrojmë Shqipërinë nga droga e llumi

... qartë raportit:

1. "Shqipëria është vendi i origjinës së shumicës së sasive të kanabisit që kanë si destinacion tregjet italiane dhe evropiane".

2. Vetëm në vitin 2017, mbi 90 ton janë kapur nga rreth 41 ton që ishin në vitin 2016".

3. Klanet shqiptare kanë treguar se kanë një aftësi në rritje të menaxhimit në kultivimin e marijuanës dhe trafikimit të saj".

4. "Grupet e krimit shqiptar konkurrojnë me organizatat të tjera kriminale europiane për kontrollin e territorit të rrugëve e të trafikimit të drogës.

5. Shqiptarët zënë vendin e parë në rrejet kriminale të huaja të narkotrafikut të përfshirë në trafikun e drogës.

6. Raporti vlerëson se 94 rastet e raportuara në vitin 2017 të trafikimit të drogës janë më të lartat në dekadën e fundit ndërkohë që vlera më e ulët shënohej në vitin 2011, me 49 raste.

8. "Por grupet shqiptare nuk e kanë kufizuar aktivitetin e tyre vetëm në trafikun e marijuanës. Raporti i Antidrogës italiane

shpreh shqetësimin se "së bashku me 'Ndrangheta' në Kalabri, e cila falë një rrjeti kompleks të lidhjeve ndërkombëtare ka ende një rol kyç në trafikimin e kokainës në Itali, gjatë vitit 2017.

9. "Shqiptarë vijnë të dytët në personat e huaj të arrestuar për trafik dhe shpërndarje të kokainës (me rreth 1.100 persona të arrestuar).

Kurse nga 10 mijë të huaj të arrestuar për trafik droge, 2000 janë shqiptarë.

Raporti tregon që propaganda e paguar e Edi Ramës nuk duhet të na verbojë por të na zgjojë.

Të parat duhet Ne nënat dhe gratë të bëhemi bashkë për të shpëtuar fëmijët dhe familjet shqiptare.

Po na shkatërron rininë dhe të ardhmen.

Po na shkatërron kulturën dhe historinë.

Po na shkatërron themelin e shtetit, vlerat mbi të cilat ky vend mbijetoi për shekuj të tërë.

Raporti i fundit është dëshmia e qartë e rrëniminjtë dhe e ka



çar vendin Edi Rama dhe banditizmi i tij.

Askush më parë nuk ka qenë kaq thellë i përfshirë në trafikun dhe llumin e bandave.

Askush më parë nuk ka qenë kaq arrogant dhe tallës ndaj probleme dhe halleve të shqiptarëve.

Askush më parë nuk i ka shpallur lufte biznesit, intelektualeve,

teatrit duke qene thjesht armik i popullit te vet.

LSI ka në plan që për 3 muaj të pastrojë Shqipërinë nga droga dhe llumi i Edi Ramës.

Të gmontojë këtë qeveri dhe të shembi këtë sistem dhe për 3 muaj Shqipëria ti kthehet normalitetit dhe zhvillimit ekonomik.

Sekuëstrim të pronave mafioze dhe pastrim të Shqipërisë nga paratë e pista

Taksat e ulëta
Konkurrenca e pastër
Zhdurka monopoleve
Rikthimi i barazisë dhe demokracisë.

Shëndetësi dhe arsim të barabartë për të gjithë pa dallim bindje politike.

Të shpëtojme trashëgiminë kulturore.

Të shpëtojme identitetin tonë. Çmontimi i kësaj qeverie është hapi i parë.

*** Deklarata për media e Kryetares së Lëvizjes Socialiste për Integritim, Monika Kryemadhi**

Dje në "Deutsche Welle"

Terrori i djathtë - dështim i shtetit

Nga Hans Pfeifer

E gjitha me të zeza është ve shur Kancelarja gjermane kur del në shkurt 2012 në pulitim e oratorit dhe bën një premtim. Në këtë ditë dimri, në Berlin është mbledhur udhëheqja e shtetit gjerman, për të mbajtur zi. Viktimat nuk janë as të shquar, as kanë pasur pushtet. Me një përjashtim ata janë migrantë. Beate Zschäpe dhe terroristët radikalë të djathtë të të vetëquajturës "Lëvizje klandestine nacionalsocialiste" (NSU) i vranë ata pikërisht për këtë shkak: për gjashtë vjet me radhë banda vrasare erdhi vërdallë nëpër Gjermani, grabiti, hodhi bomba dhe vrau. Motivi i tyre: urrejti raciste ndaj imigrantëve. Dhe askush nuk i ndali. Asnjë polici, asnjë shërbim i fshehtë, asnjë qeveri.

DYSHIME PËR VIKTIMAT

Edhe më e keqja: autoritetet gjermane të sigurisë vunë nën dyshim si kriminelë viktimat dhe familjet e tyre. Dyshuan për ta si tregtarë droge dhe anëtarë të mafias. Klishe raciste karakterizuan hetimet e policisë. Për Gjermaninë, që është krenare për rivlerësimin e krimeve nacionalsocialiste, kjo është një deklaratë falimentimi. Një dështim shtetëror.

Në këtë shkurt 2012 Kancelarja u kërkon falje dhjetë familjeve të viktimave të vrara. Dhe premtim: "Ne do të bëjmë gjithçka për të sqaruar vrasjet dhe për të zbuluar bashkëfajtorët dhe organizatorët dhe për t'i vendosur të gjithë dorasit para dënimit të tyre të drejtë". Ky është një premtim i madh. Dhe është shpresa më e madhe, që kanë familjet e viktimave për trajtimin juridik të vrasjeve me paramendim. Tani, kur mori fund procedura spektakulare penale e viteve të shkuara para



një gjykatë gjermane është e qartë: premtimi nuk u mbajt.

Sepse përpjekjet e politikës dhe të gjykatave për një sqarim të plotë nuk zgjatën shumë. Shpejt u bë fjalë për fytyrën e shquar të të dyshuarës kryesore që u dënua tani, Beate Zschäpe. Rrjeti i ndihmësve dhe i

mbështetësve të djathtë, që ishte i domosdoshëm për dorasit, ndërthurja e dukshme e shërbimeve të fshehta në dështimin e institucioneve për të sqaruar - e gjitha kjo kaloi hap pas hapi në harresë. Edhe te Kancelarja. Deri sot shërbimet e fshehta dhe ministratë ruajnë heshtjen, kur

bëhet fjala për kontributin e tyre për rivlerësimin e asaj që ndodhi. Dhe para gjykatës doli vetëm një prerje e vogël e një rrjeti të madh mbështetësish.

URREJTJA KA MBËRRITUR NË PARLAMENT

Por dështimi i shtetit është shumë më i rëndë. Sepse atëherë, në vitin 2012, Kancelarja premtoi se do të vepronte kundër atyre të cilët "i përndjekin të tjerët për shkak të prejardhjes së tyre, të ngjyrës së lëkurës dhe të fesë". Por sot, gjashtë vjet më vonë, racizmi dhe mendimi nacionalist kanë sërish vend në shoqëri, madje në parlamentin gjerman. Ato kanë me AfD-në një zë agresiv të urrëjtjes. Kjo në një kohë kur procesi kundër NSU-së e konfirmoi: urrëjtja vret.

Në këtë shkurt 2012 Kancelarja u kërkon falje dhjetë familjeve të viktimave të vrara. Dhe premtim: "Ne do të bëjmë gjithçka për të sqaruar vrasjet dhe për të zbuluar bashkëfajtorët dhe organizatorët dhe për t'i vendosur të gjithë dorasit para dënimit të tyre të drejtë".

HOROSKOPI

DASHI

Ndjenjat në çift janë të forta, por përsëri nuk është e mjaftueshme. Nëse partneri përpiqet t'ju fusë në "kurth" duke folur ju për të ardhmen, ju bëni menjëherë një hap prapa. Do të keni kontakte të shpejta dhe fitimprurëse. Nëse i keni mbyllur punë e javës, vazhdoni përpara me veprimtaritë të tjera.

DEMI

Hëna e zellshme do të jetë në anën tuaj, ndërsa Venusi ju rekomandon blerjen e sendeve të shtrenjta, duke ju bindur se prestigji dhe suksesi ecin krahas për krahas. Në punë do të jeni energjikë.

BINJAKET

Nëse jeni të dashuruar, do të shkoni pak përtej arsyesh. Do të bëni sjejlje të çuditshme, do të bëni deklaratatë dramatike, do të argoni ëmbëlsitë të pakufishme për personin që ju tërheq. Sot do të jeni në humor të mirë dhe do të keni fat në veprimtaritë që ndërmerrni.

GAFORJA

Hëna do të jetë e heshtur dhe Venusi do të jetë tekanjor, sot dashuria nuk ecën. Ndërkaq ju ngushëllon detyria Diell-Pluton, garantuese të një atmosfere miqësore dhe të shndritshme. Financat duhet t'i keni në vëmendje dhe ju takon jave të bëni vlerësimin e duhur për të mos shpenzuar shumë.

LUANI

Venusin do ta keni kundra, por nuk ju sjell ndërlikime. Ndërkohë, e mbështetur nga aspekti pozitiv i Hënës, nxjerr në pah interesin reciprok. Do të jeni të lumtura dhe të kënaqur, aq sa të ndryshoni qëndrimin duke ju hapur dhe dëgjuar nevojat dhe dëshirat e partnerit.

VRIGJERESHA

Keni një familje të dashur dhe fëmijët të mirë, por ju mungon diçka dhe madje shumë, një person nga e kaluara, që ende nuk arrin ta harroni. Është e nevojshme të ndryshoni menjëherë dietën. Efektet e para do të jenë të dukshme në lëkurë, e cila do të jetë më e shkelqyer dhe e butë.

PESHORJA

Në çift do të jeni të lumtur dhe të kënaqur, si në përallta. Rregulli juaj është të ballafaqoheni për çdo gjë, por pa e ngritur zërin, me dashamirësi dhe diplomaci. Do të vendosni të ndërmerrni një udhëtim në minutën e fundit, për të festuar një përvojë dashurie ashtu siç duhet.

AKREPI

Do të keni momente magjike në punë, ku çdo gjë ecën në përsosmëri, të frymëzuar nga një fillad gjeniu krijues dhe të mbështetur nga shija e juaj estetike. Është dita ideale për ata që merren me modën, bukurinë dhe mirëqenien, por edhe për ata që punojnë për marrëdhëniet me publikun.

SHIGJETARI

Venusi dhe Hëna janë të gatshëm që t'ju inkurajojnë dhe t'ju japin një dozë vetëbesimi! Do të keni marrëdhënie të qeta me ambientin që ju rrethon. Pas një sqarimi, jeta në çift do të bëhet më e ëmbël. Partneri do të jetë më pak i ngurtë dhe do të ketë më shumë mirëkuptim.

BRICJAPI

Revolucionarë të zemrës, synoni harmoninë që zbut mosmarrëveshjet, duke filluar nga jeta në çift, ku komunikimi bëhet jetik. Dëshirat shumëfishohen nga Venusi, kështu që në modë dhe produkte kozmetike do të bëni shpenzime të mëdha.

UJORI

Do të keni krijimtari të shkëlqyeshme në punë. Originaliteti i bashkëngjitet çdo nisme. Nën drejtimin tuaj, edhe gjëja më e parëndësishme ka personalitet. Me kolegët formoni një ekip të ngushtë, që beson të bashkëpunimi dhe që përballat me sfida.

PESHQIT

Të pakënaqur nga Hëna, si edhe me Venusin e burgosur në shtëpinë tuaj të dymbëdhjetë, për sot nuk bëhet fjale për aventura dashurie! Si kompensim, mbështetja e Diellit dhe Plutonit hap rrugën për një miqësi të veçantë, intensive dhe intime.

Kualifikimi i Kroacisë sjell gëzim në Spanjë dhe në veçanti Atletikon e Madridit. "Kolconeros" janë skuadra më e përfaqësuar në finale me katër lojtarë. Tre luajnë për Francën dhe një për Kroacinë. Grizman, Lukas, Lemar dhe Vrsaljko. Kaq mjafton që të konsolidojë liderшипin skuadra e dytë e Madridit. Në fund të fundit nuk është rastësi pasi Atletiko është e dyta në ren-



Atletiko Madrid dominon finalen e Botërorit

"Los Colchoneros" kanë 4 lojtarë në finale, ndjekin Reali, Barça dhe Juvja me nga 3

ditjen e UEFA-s. Kurioz është fakti se mes stollit dhe fushës, në Moskë do të jetë edhe një lojtar që në të shkuarën ka përfaqësuar Atletikon, i pandalshmi Mario Manxukiç. Edhe Reali është i mirëpërfaqësuar. "Los Blankos" kanë cilësi dhe përbërje, Varane,

Modriç dhe Kovaçiç. Të tre me një objektiv të njëjtë, por që nuk do mund ta gëzojnë të gjithë: të fitojnë Champions League dhe Botërorin në të njëjtin sezon. Në podiumin e skuadrave më të përfaqësuar nuk mund të mungonte Barce-

lona, që në radhët e saj ka Rakitiç, Umtiti e Dembele. Aq sa mjafton për ta bërë La Ligan dominuese në një turne kaq të veçantë. Mes francezëve dhe kroatëve, 11 lojtarë vijnë nga kampionati spanjoll, ndjek Liga e parë franceze me nëntë element dhe më pas Serie A

me shtatë. Konfirmohet edhe Juventus, që futet në mbretëreshat e Europës, sepse ka tre lojtarë si Reali dhe Barcelona në finalen e Botërorit. Përveç Mario Manxukiç janë edhe Blez Matuidi e Marko Pjaca, por ky i fundit duket se nuk do të luajë. Pas Juventusit vjen Interi me 2 elementë, të dy kroatë, Perisiç dhe Brozoviç. Në fund të renditjes, vjen kampionati anglez, që në finale përfaqësohet në total nga gjashtë lojtarë.

Të dy duan titullin, Dëshamp për të hyrë në "Hall of Fame", Daliç për të realizuar ëndrrën e Kroacisë

"Europa League"

Partizani paguan gabimin në mbrojtje

Partizani ka humbur me rezultatin 0-1 ndaj Mariborit në turin e parë eliminator për "Europa League", në ndeshjen e zhvilluar në "Selman Stërmasi". Në një takim ku ekipi i Skënder Gegës ka luajtur si i barabartë me kundërshtarin, nuk ka arritur t'ia dalë ndaj Mariborit, që ishte favoriti i këtij takimi, duke parë eksperiencën e madhe që ka në arenën europiane. Të kuqtë kanë paguar gabimin e mbrojtjes, teksa pas pasigurisë së Kalarit dhe Belicës, kundërshtarët nuk e kishin të vështirë për të dërguar topin në rrjetë. Partizani ka pasur edhe një rast ku ka kërkuar penallti nga gjyqtari, që nuk e ka akorduar dikja të tillë edhe pas ndërhyrjes që iu bë Asanit në brendësi të zonës. Në fund ka vend edhe për një dritërimë nga distanca falë gjuajtjes së Abdurahimit, por pa e ndryshuar rezultatin.

Jeton Selimi

Zllatko Daliç zbarkoi në Tiranë një ditë korriku të vitit 2008, një dekadë përpara se të nënshtrohej gjysmën e planetit me Kroacinë e tij. Asokohe ishte 41 vjeç dhe u prezantua në krye të Dinamos, asaj Dinamoje që ende nuk ishte bërë viktimë e Zotave të rinj të futbollit tonë. Një Dinamo që sapo ishte shpallur kampione për herë të 17-të. Zllatko Daliç kishte kaluar një jetë si mesfushor shkatërrues mes Varteksit dhe Hajdukut, pa përfshirur ndonjë huazim, ndërsa Dinamo ishte aventura e parë jashtë vendit. 41-vjeçari Daliç u prezantua para mediave veçur me uniformën e dytë sportive të klubit kryeqytetas, në krah të presidentit Besnik Sulaj. Me Dinamon fitoi menjëherë Superkupën e Shqipërisë, që fatkeqësisht do të ishte trofeu i vetëm për të me blutë. Ashtu si paraardhësi i tij kroat, Luka Bonaciç, Daliç nuk e mbaroi sezonin. U shkarkua një ditë prilli pas humbjes në derbi me Partizanin, ndërsa më herët ishte mposhtur nga Tirana. Opinioni vendës ishte i ndarë rreth aftësive të tij. Ata që kuptojnë nga futbollit pa dashakeqësinë në mes, pranuan se Daliç ishte një trajner premtues. Por zëri i tyre ishte i vogël përpara uturimës së zakonit të zlliq-

Daliç-Dëshamp, ose dueli i mesfushës

Kroati ndjen peshën e titujve të të dytit



arëve që nuk pranoni dot "çibanin e huaj" në kampionatin tonë dhe shkarkimin ia futuronin mosnjohjes së kampionatit nga trajneri i ri. Një faturë që e ka paguar çdo trajner i huaj që ka shkelur në superiore, pavarësisht af-

tësive të tij. Një faturë që u është imponuar me pa të drejtë nga ata që këtij futbollit më shumë i kanë marrë sesa i kanë dhënë, dhe kjo në emër të kontributit të së shkuarës. Zllatko Daliç nuk e pa më Shqipërinë. Karriera e

tij vijoi në kampionatet e Gjirit Persik mes Arabisë dhe Emirateve. Derisa Kroacia shkarkoi Ante Čačić për mungesë rezultatesh. Federata kroate i besoi stolin Daliçit dhe mesfushori shkatërrues arriti të farkëtojë një ekip që në këtë botëror ka mahnitur çdokënd me forcën e tij të karakterit. Kur sheh Manxukiçin të vrapojë si një djalosh, Perisiç që mbron e shënon, për të kaluar më pas të dyshja e mrekullueshme Rakitiç-Modriç, në duart e të cilëve janë çelësat e mesfushës së Barcelonës dhe Realit, kupton se Kroacia veç talentit të pashtershëm ka edhe taktikën e duhur që e ka bërë të arrijë finalen. Ky grup djemsh ka lënë pas shpine një brez jashtëtokësorësh si Zvonimir Boban, Davar Shuker, Alen Boksiç, apo Robert Prosinečki. Zagrebi ka festuar një arritje që është his-

torike ende pa e luajtur finalen. Përballë Daliçit do të jetë Didie Dëshamp, një që rolin në fushë e ka pasur identik me kroatin, por palmaresin shumë të pasur, me tituj kampioni dhe 2 Champions League me Marsejën dhe Juventusin. Por gjithçka kulmoi me Kombëtarën e "gjelave" ku në vitin 1998 fitoi Kupën e Botës dhe 2 vjet më pas europianin. Dëshamp ka në qafën e tij dhe një medalje argjendi në "Euro 2016" si trajner, ndërsa përballë Kroacisë do të kërkojë të arrijë Bekenbauerin e Zagallon, te vetmit që Kupën e Botës e kanë fituar qoftë si lojtarë e qoftë si trajnerë. Përballa Dëshamp-Daliç do të jetë njëjtë si ajo mes Golias e Davidit, me kroatin që në këtë Kupë Bote ka treguar se nuk i druhet aspak emrit të madh që ka përballë!

Anorthosis fiton 2-1

Laçi humbet në Qipro, por ka mundësi kualifikimi

Laçi është afruar shumë mrekullisë në ndeshjen e Ligës së Europës përballë Anorthosis. Ndonëse ka vuajtur në mbrojtje për pjesën më të madhe të takimit, ekipi kurbinas iu afrua shumë një rezultati surprizë, pasi 8 minuta shpërqendrim i kushtuan përmbysjen nga 1-0 për të, në 2-1 për vendasit. Ndaj qipriotëve, ishte e qartë që skuadra e Prengës do të mbrohej dhe ajo e bëri këtë me shumë rregull në minutat e para, duke goditur më pas në rastin e parë që iu shfaq me Hoxhallarin për të kalu-

ar në avantazh. Më pas, vazhdoi i njëjti skenar, me kurbinasit në pritje në zonën e tyre dhe kundërshtarët që gjenin pak të cara për të rrezikuar Selmanin. Kur dukej se gjithçka ishte nën kontroll, erdhën 8 minuta që ndryshuan fatin e sfidës. Fillimisht Shubina shkaktoi 11-metërsh për të sjellë golin e barazimit e më pas, mbrojtja e Laçit nuk arriti të largonte një top nga zona pas një goditje nga këndi, duke i dhënë mundësinë Cise që të kthente

ndeshjen në favor të qipriotëve. Vendasit krijuan edhe disa raste të tjera, por edhe Laçi kishte pranë fundit një mundësi të artë me Hoxhallarin për të dërguar topin në rrjetë, por një devijim i portierit pas një goditje dënimi i mohoi gëzimin e golit për herë të dytë mbrojtësit. Gjithsesi, edhe rezultati përfundimtar 2-1 në transfertë nuk është i keq për kurbinasit, të cilët do të provojnë shanset e tyre në ndeshjen e kthimit në javën e ardhshme

Ventspils fiton 5-0

Luftëtari, humbje e turpshme në debutimin historik


Luftëtari është mundur me rezultatin e thellë 5-0 në ndeshjen e parë të tij në arenën ndërkombe të sfidën përballë Ventspils në Letoni. Një ndeshje me dy fytyra e gjirokastroitëve, të cilët nuk ishin prezent në fushë në pjesën e parë të ndeshjes, e më pas u munduan të reagonin në të dytën. Dy penallti të shkaktuara dhe çdo dylluftim i humbur nga zikaltërit në pjesën e parë sollën pesë gola në portën e Bukovskit, i cili nuk kishte çfarë të bënte përballë goditjeve të njëpasnjëshme në portën e tij me ekipin e Koshtiç që dukej i pafuqishëm të reagonte. Në pjesën e dytë, Luftëtari dhuroi një tablo



tjetër, ndoshta edhe për tërheqjen e vendasve. Ekipi shqiptar ishte më agresiv, duke kërkuar me ngulm të paktën golin e nderit. Por gjyqtari qipriot u bë protag-

onist i sfidës duke anuluar një gol të Shkurtajt e më pas duke mos akorduar një tjetër kur topi kishte kaluar vijën fatale, pa harruar këtu faulltet që jepte në çdo rast në favor të ekipit vendas. Shkurtajt ishte i pafat edhe kur goditi traversën e portës kundërshtarë, duke mbyllur ndeshjen pa shënuar gol, që do ta kërkojë për statistikë në takimin e kthimit, pasi kualifikimi i mëtejshëm i Luftëtarit është kthyer në utopi që pas 45 minutave të para.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

- Lindi Isakun.
- Në krye të bashkisë.
- Në djep kur nuk... je.
- Nota e diapazonit.
- Emri i parë i Erasmit të Rotterdemit.
- Mbyllin akte.
- Filozofi i famshëm me historinë e gomarit.
- Diku në qendër.
- Rrallë është përgjysmë.
- Bëri edhe Madame Butterfly.
- Norman, psikopati te Psycho.
- Të parat në sjellje.
- Vret me një re.
- Gjarpi që u vra nga Apolloni.
- Lindi Perseun.
- Besniku mesfushor
- Ai i vajtimt është në Jerusalem.

29. Carol, aktore.
 30. Në krye të subjekteve.
 31. Rrëmbeu Helenën.
 33. Fundi i një samurai.
 35. Ishin hipokritë për Krishtin.
 37. Ngrin... nga frika.
 39. Përdorej kundër malaries.
 40. Perëndia që u zu në gjumë nga Mene-lau dhe Aristeu.
 44. Tund në ekstreme.
 45. Piaf e Milord.
 46. Në hyrje të sallës.
- VERTIKAL**
1. Ishte sundimtari i provincave perseisha.
 2. Inicialet e Duvall
 3. Qytei i njembinjëdritarve.
 4. Ishin armiqëetë babilonasve.
 5. Shkroi Jacuqes le fataliste
 6. Eshhtë edhe tendencë.
 7. Joan i interpretuar nga Celentano.
 8. Jetojnë në vetmi.
 9. U soll në Europë në Jean Nicot.
 10. Ai i Aida-s është Radames.
 11. Një ishte edhe Decebail.


13. Inicialet e Rohmer regjisor.
18. Titulli i Bruce Springsteen.
20. Hidhet një me... kërcim.
22. U shkrua nga Camus.
23. Fillojnë takimin.
25. Fillojnë natën.
27. Pierce teniste.
28. Grisur pa gur.
31. Fillojnë panikun.
32. Shijuar pa shuar.
34. Fleming, që krijoi James Bond.
35. Kështu merr ai që... mbaron.
36. Mbjajtësja e topit në golf.
37. Ekstreme për gotik.
38. Carson i fumnetit-t.
40. Një padi kur s'është ai.
41. Bëhen arianë me një anë.
42. Harris që krijoi Hannibal Lecter (inic).
43. Bëhet nuse me re.

Fjalëkryqi (2)


HORIZONTAL

- Emri i Monet.
- Një top në rrjetë.
- Carl Edward, që shkroi Contact.
- Qe bukuoshi që u hidhte ferë perëndive.
- Qe era hynjore e japonezëve.
- Një pjesë e lartësive.
- Muzikanti që... nuk përsëriste.
- Lumë në Rusi.
- Eshhtë i lartë ai i kampionit.
- Kalifi që themeloi Kairon.
- Kështu e quajti Krishti shën Pjetrin.
- Janë në guvë.
- Ilioni portier.
- Markë makine.
- Ashtu si duhet të përgjigjet fituesi.
- Inicialet e Mann.
- Një parabolë e tenistit.


- Fillojnë tatepjeten.
 - Ente Autonome.
 - Jean, që solli duhanin në Europë.
 - Mund të jetë dëshmor.
 - Pak stabilitet.
 - Arturo i Brecht.
 - Një pjesë e onkologjisë.
 - Mbyllin një shtëpi.
 - Të parat në stafetë.
 - Qe profet i vogël.
 - Me break në tenis.
 - Mbyllin një sirtar.
 - Qe perëndesha që lindi Arionin.
- VERETIKAL**
- Inicialet e Santana-s, kitarist.
 - Nota e diapazonit.
 - Eshhtë frika nga shehet e hapura.
 - Diftong në duar.
 - Duhen në ekstreme.
 - Qe libri erotik i Mallanaga Yatsyayana-s.
 - Lauda ish-piloti i Formula 1.
 - Janë lotët që gjithkush i derdh me kënaqësi.
 - Një poemë.
 - Fund tuneli.
 - Një eleganat si Aramis.
 - Qe kryeqyteti i Asirisë.
 - Qe teodor i famshëm.
 - Urdhëroi sakrifikimin e Ifigjenias.
 - Eshhtë pushteti i... bashkisë.
 - Qe lumi i Karontit.
 - Inicialet e Klee piktor.
 - Ishite gjuha e Jezu Krishtit.
 - U shndërrua në dre nga Afërdita.
 - Rex i Nero Wolfe.
 - Nino, kompozitori i njohur.
 - Një... story e John Le Carré.
 - Shkroi Tregime të jshhtëzakonshme.
 - Kufizojnë një sektor.
 - Inicialet e Einstein.
 - Inicialet e Matthieu, këngëtare.
 - Kufizojnë sportet.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR

M	A	T	T	C	A	S	T	E	N	T		
A	C	H	A	B	S	H	I	K	U	E	S	
L	E	B	I	P	T	R	A	N	S	I		
I	D	E	M	O	K	R	A	T	I	K	E	
I	P	A	L	E	S	T	I	N	E	Z	E	T
M	A	N	A	S	T	I	R	E	T	E	O	R
A	G	I	A	E	I	S	N	R	E	T		
T	A	R	T	A	R	I	Q	T	S	J		
T	E	N	T	E	T	U	R	E	K	A	V	E
R	E	A	L	E	R	E	P	A	R	T	E	T
I	T	A	T	O	T	E	S	T	E	T		
A	A	T	I	A	S	T	E	R	I	C		

FJALËKRYQI (1)

M	I	C	K	U	A	S	K	I	L	E	T	
I	L	R	T	R	O	M	A	N	E	T		
T	K	E	R	M	I	L	L	I	N	J	E	
T	B	A	N	A	N	E	T	M	A	D	E	M
T	E	P	A	R	E	T	M	A	S	A	I	
H	A	R	E	A	N	P	L					
M	A	K	E	T	I	A	L	I	E	N	I	
O	R	E	T	L	E	G	A	K	A	P	O	
T				F	I	T	I	M	E	T	A	
R	E	N	D	O	R	M	E	T	O	R	E	
A	H	O	T	E	L	E	T	T	R	I	S	
T	T	M	O	T	E	T	A	M	A			

FJALËKRYQI (2)

SUDOK

			7	2				
	5							4
4				1				
5	2		6				4	
	4		9					8
8	3							1
2	6		5			9		
9			2	8		1	5	
3							6	

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

8	3	6	1	4	7	2	5	9
2	5	9	3	6	8	4	7	1
4	7	1	9	2	5	3	6	8
5	6	8	4	3	1	7	9	2
7	9	3	8	5	2	6	1	4
1	2	4	6	7	9	8	3	5
9	4	7	2	1	6	5	8	3
3	1	5	7	8	4	9	2	6
6	8	2	5	9	3	1	4	7

Argëtim filozofik

- Atje ku hapet një shkollë, mbyllet një burg.
- Momente të këqija të jetës ekzistojnë për të na bërë të vlerësojmë më shumë momentet e mira
- Nëse nuk je lënduar, nuk mund të thuash se ke jetuar.
- Më mirë i çmendur me të gjithë, se sa i matur dhe vetëm.



KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

K	A	E		2	1	6	3	10	2		S	A	F	O	M	A	M	L	A	F			
1	9	1	8		11	1	12		2	3	7	A	N	A	K	O	S	T	U	M	E	R	
3	2	2		13	3	11	1	2	4	2	4	R	K	A	K	T	O	R	I	A	L	E	
3	2		13	3	7	3	2	4	5	3	2	A	L	K	L	E	O	P	A	T	R	A	
15		5	9	8	4	2	3	2	3	2		F	U	K	I	T	R	E	T	I	S		
9		3	5	4	11	3	2		2		12	L	A	N	G	E	K	I	B	F	K		
7	4	5		10	3	2		2	1	11	1	B	U	R	G	U	A	A	A	R	I	U	
4		9		15	16			17	2	4	6	A	T	A	L	N	U	R	A	T	A		
5	1		17	20	4	10	15			17	6	S	K	E	D	A	R	E	A	A	O	D	
3	9		11	1	2	3	10	2	1	2		M	I	L	A	O	M	E	B	U	R	R	
	10	1		19	3			18	7	1	2	A	N	A	L	I	T	I	K	E	L	E	A
1	19	8	4			11	4	7	1	2	4	T	A	T	E	A	K	T	O	R	I	T	

- Ai që dëshiron të jetë vazhdimisht i lumtur, duhet të ndryshojë shpesh.
- Të jesh i këndshëm dhe i sjellshëm me të gjithë, por, të miqësosh me të zgjedhurit.
- Hapi i parë për të arritur gjërat që dëshiron në jetë është: vendos çfarë do.
- Njerëzit në përgjithësi gjykojnë më shumë nga fenomenet sesa nga realiteti...
- sepse vizioni u takon të gjithëve ... ndërsa konceptimi të paktëve...

Thënie të mençura

